



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# RAPORT STUDIMOR

PËR DENONCIMIN, HETIMIN DHE GJYKIMIN E  
VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

(Referuar analizës së disa kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ecursisë së hetimit dhe gjyqimit të tyre, si dhe gjetjeve të rezultuara nga monitorimi i disa seancave dhe vendimeve gjyqësore për gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit)

*Të luftojmë së bashku  
korrupsionin dhe të  
kontribuojmë në ndërtimin  
e një shoqërie më të mirë dhe  
të drejtë për të gjithë ne!*



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# RAPORT STUDIMOR

PËR DENONCIMIN, HETIMIN DHE GJYKIMIN E  
VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

(Referuar analizës së disa kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ecursë së hetimit dhe gjyimit të tyre, si dhe gjetjeve të rezultuara nga monitorimi i disa seancave dhe vendimeve gjyqësore për gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit)

**Dhjetor, 2016**

## U angazhuan në realizimin e monitorimeve dhe hartimin e raporteve:

1. Florian Xhuhani, *Jurist*
2. Etilda Saliu (Gjonaj), *Juriste*
3. Erida Skëndaj, *Juriste*
4. Elton Frashëri, *Jurist*
5. Iva Bregasi, *Juriste*
6. Andi Muratej, *Avokat*
7. Edis Ibrahim, *Jurist*
8. Klodian Reçi, *Jurist*

## Përgatitën publikimin për shtypshkrim:

1. Erida Skëndaj, *Drejtoresh Ekzekutive e KShH-së*
2. Niazi Jaho, *Këshilltar Ligjor i KShH-së*
3. Elton Frashëri, *Jurist në Programin e Klinikës Ligjore në KShH*

**Redaktor:** Ilir Dhima

Botimi nën kujdesin e “petanidesign”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Autor: @ Komiteti Shqiptar i Helsinkit



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Ap. 10, K. 5, K.P. nr. 1752, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: ++355 (0)4 223 36 71, ++355 (0)69 407 57 32

web address: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)

*Ky publikim mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.*



Embassy of the United States of America  
Tirana, Albania

*“Shoqëria u ka besuar gjyqtarëve një rol shumë të rëndësishëm. Ata kanë për detyrë të vlerësojnë të mirën dhe të keqen, dhe në rast nevoje të japin dënime të ashpra. Por megjithatë pritet që ata të veprojnë nën kontrollin publik dhe të sillen në mënyrë korrekte. Në qoftë se nuk i përmbushin këto parashikime zbulohen ndaj kritikës, nga e cila nuk e meritojnë të mbrohen. Shoqëria demokratike dhe shprehësit e saj (të tillë si gjyqtarët) duhet të lejojnë edhe kritikën pak të tepruar, të mbështetur në fakte të padiskutueshme”.*

**M.A Nowicki,** *Rreth Konventës Europiane,*  
botimi i vitit 2000, fq. 317

## PËRMBAJTJA

|     |                                                                                                                                                                                                             |    |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.  | Hyrje.....                                                                                                                                                                                                  | 5  |
| 2.  | Opinion i pavarur për Raportin Studimor, nga Av. Arben Rakipi.....                                                                                                                                          | 9  |
| 3.  | Përmbledhje ekzekutive.....                                                                                                                                                                                 | 12 |
| 3.1 | Ecuria e hetimit të disa kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit.....                                                                                                                          | 12 |
| 3.2 | Gjetjet lidhur me monitorimin e disa seancave gjyqësore.....                                                                                                                                                | 16 |
| 3.3 | Gjetjet lidhur me analizën e disa vendimeve gjyqësore.....                                                                                                                                                  | 17 |
| 4.  | Analizë mbi ecurinë e kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës.....                                                        | 23 |
| 4.1 | Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur.....                                                                                                                                                            | 23 |
| 4.2 | Analizë e përgjithshme.....                                                                                                                                                                                 | 24 |
| 4.3 | Analizë për çështje të veçanta.....                                                                                                                                                                         | 26 |
| 5.  | Praktika e denoncimeve të institucioneve të tjera të kontrollit.....                                                                                                                                        | 36 |
| 6.  | Gjetjet e rezultuara nga monitorimi i seancave gjyqësore për çështjet e korrupsionit të gjykuara në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit Tiranë dhe Durrës, si dhe në Gjykatën e Krimeve të Rënda..... | 39 |
| 6.1 | Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur.....                                                                                                                                                            | 39 |
| 6.2 | Gjetjet lidhur me aspektet e procesit të rregullt gjyqësor dhe mbarëvajtjen në gjykatë.....                                                                                                                 | 40 |
| 6.3 | Gjetjet lidhur me aspektet tematike të lidhura me gjykimin e të pandehurve të akuzuar për veprat penale në fushën e korrupsionit.....                                                                       | 47 |
| 7.  | Analizë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për çështjet e korrupsionit të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit në Tiranë dhe Durrës, si dhe nga Gjykata e Krimeve të Rënda.....        | 51 |
| 7.1 | Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur.....                                                                                                                                                            | 51 |
| 7.2 | Respektimi i aspektit formal dhe procedural të zbardhjes së vendimit.....                                                                                                                                   | 54 |
| 7.3 | Gjendja gjyqësore e të pandehurve.....                                                                                                                                                                      | 56 |
| 7.4 | Masat shtrënguese për të pandehurit.....                                                                                                                                                                    | 56 |
| 7.5 | Subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal.....                                                                                                                                                       | 58 |
| 7.6 | Analizë mbi pranimin e kërkesave për gjykim të shkurtuar.....                                                                                                                                               | 60 |
| 7.7 | Shkaqet e zvarritjeve të seancave gjyqësore për ato çështje që kanë zgjatur mbi mesataren.....                                                                                                              | 62 |
| 7.8 | Arsyetimi i vendimeve gjyqësore.....                                                                                                                                                                        | 64 |
| 7.9 | Qëndrimi i gjykatës për kualifikimin ligjor të veprës penale dhe politikën penale.....                                                                                                                      | 70 |
| 8.  | Rekomandime.....                                                                                                                                                                                            | 75 |

## 1. Hyrje

Gjatë veprimtarisë 26 vjeçare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i ka kushtuar vëmendje të veçantë studimeve dhe raporteve analitike për pandëshkueshmërinë e veprave penale në fushën e korrupsionit në vendin tonë. Ky raport studimor është botimi i dytë i dedikuar vetëm për analizën e fenomenit të pandëshkueshmërisë së korrupsionit në vend, të cilin KShH ia prezanton publikut, medias, institucioneve shtetërore, aktorëve të sistemit të drejtësisë, organizatave vendase dhe ndërkombëtare, si dhe të gjithë të interesuarve të tjerë brenda dhe jashtë vendit.

Qëllimi i këtij studimi është të kontribuojë në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe performancës së institucioneve që kanë përgjegjësi ligjore për kallëzimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, duke synuar gjithashtu evidentimin e praktikave pozitive institucionale, hetimore dhe gjyqësore, si dhe atyre praktikave që kanë nevojë të unifikohen.

Perceptimet në nivele të larta të qytetarëve për përhapjen e korrupsionit në sektorin publik, numri i lartë i kallëzimeve penale drejtuar organit të prokurorisë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, disbalanca midis numrit të lartë të këtyre kallëzimeve penale me numrin e çështjeve të hetuara nga prokuroria dhe të dërguara për gjykim, aq më tepër me numrin e të pandehurve që janë deklaruar fajtorë më vendim gjyqësor të formës së prerë ishin disa nga faktorët kyç që diktuan nevojën për të bërë një analizë profesionale, objektive dhe të paanshme mbi efikasitetin e veprimtarisë së KLSH-së, institucioneve të tjera të kontrollit/të pavarura, prokurorisë dhe gjykatave sa i takon parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit në vend.

Raport-Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2015<sup>1</sup>, ka theksuar se historiku i të dhënave të dënimeve për rastet e korrupsionit që përfshijnë zyrtarë shtetërorë të nivelit të lartë është i ulët. Një numër rastesh, kur mediat kanë hedhur dyshime për shkelje të kryera nga zyrtarë të lartë, gjyqtarë dhe prokurorë, nuk u hetuan në mënyrë serioze. Në këtë raport është theksuar se, me gjithë ndryshimet e kuadrit ligjor dhe institucional, përsëri evidentohen mangësi, si: paqartësia e juridiksionit mbi veprat penale të korrupsionit; pamjaftueshmëria në burimet njerëzore

---

1 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2015, Bruksel 10.11.2015

dhe teknike, mungesa e bashkëpunimit efektiv dhe besimit ndërmjet policisë dhe prokurorëve, mungesa e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit aq sa duhet me institucione të tjera. Sanksionet e vendosura në rastet e korrupsionit kanë prirje të jenë tepër të buta. Gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për autorizimin e teknikave të posaçme të hetimit dhe për pranimin e provave të marra në mënyrë të paligjshme, të tilla si regjistrimet private. Vendimet e gjykatave shpesh janë të shkruara dhe të argumentuara me frymë të topitur.

Raport-Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, vlerëson se, në lidhje me luftën kundër korrupsionit, Shqipëria është deri diku e përgatitur. U miratua ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve. Prokurorët dhe policia kanë rritur aksesin në regjistrat elektronikë kombëtarë publikë, me qëllim shkëmbimin e informacionit sensitiv dhe rritjen e efikasitetit të hetimeve. Nevojitet përparim i mëtejshëm për krijimin e një historiku të qëndrueshëm (*track record*) të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve. Nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin në nivel të lartë. Hetimet pro aktive, vlerësimet sistematike të riskut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional duhet të përmirësohen. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz. Sa i takon çështjeve të lidhura me drejtësinë dhe korrupsionin, Komisioni Evropian rekomandon, se nevojitet përparim i mëtejshëm për miratimin dhe zbatimin e legjislacionit, si reformues të sistemit të drejtësisë. Dhënia e drejtësisë vazhdon të jetë e ngadalshme dhe inefficente, ndërsa korrupsioni mbetet i përhapur në të gjithë sektorin.

Reformat e zbatuara deri më tani nuk kanë dhënë rezultate të rëndësishme, ose të kenë ndryshuar perceptimin e publikut për nivelin e shkeljeve nga ana e nëpunësve publikë. Reforma në drejtësi pritet të rikthejë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Vëmendja e publikut, por edhe e organizmave vendase dhe ndërkombëtare që operojnë në vendin tonë është fokusuar te Vettingu (rivlerësimi kalimtar) i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të realizohet në 3 komponentë: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës (lidhjeve të papërshtatshme me krimin e organizuar) dhe vlerësimi i aftësive profesionale të aktorëve të sistemit të drejtësisë.

Zbatimi i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” u pezullua nga Gjykata Kushtetuese, e cila, lidhur me disa dispozita të diskutueshme të këtij ligji kërkoi opinion miqësor (*Amicus Curiae*) nga Komisioni i Venecias. Ky organizëm mbi nacional, pas shqyrtimit me ekspertizë të plotë të dyshimeve të ankmuara, më 9 Dhjetor 2016 miratoi rekomandimet e veta këshillimore në adresë të Organit të Rishikimit dhe Interpretimit Kushtetues në Shqipëri, duke u shprehur për një përputhje të ligjit të

Vetingut me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Të dhënat e siguruara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania)<sup>2</sup> tregojnë se, ndonëse dy vitet e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të hetuar nga Prokuroria për veprat penale që lidhen me korrupsionin apo shpërdorimin e detyrës, të dënuarit numërohen me gishtat e njëres dorë. Gjyqtarët e intervistuar nga BIRN bien dakord me prokurorinë sa i përket vështirësisë së hetimit të rasteve të korrupsionit. Megjithatë, ata argumentojnë që dobësitë dhe vonesat e organeve të hetimit bëhen shpeshherë shkak për dështimin e çështjeve në gjykatë. Florian Kalaja, magjistrat dhe gjyqtar në Gjykatën e Vlorës i tha BIRN, se zbulueshmëria e korrupsionit është dhe rrezikon të mbetet e vogël për shkak se ky lloj krimi krijon një situatë “win-win” mes palëve. “Ofiqarët e sistemit të drejtësisë që korruptohen nuk do të jenë ndonjëherë kallëzues të krimit të tyre; kallëzues nuk do të jenë as personat që kanë ushtruar ndikimin e paligjshëm, sepse janë përfitues... të dëmtuarit ....nuk do të flasin”, argumenton ai.

Kuadri ligjor për veprat penale të korrupsionit ka ndryshuar vitet e fundit në mënyrë të vazhdueshme, por pavarësisht kësaj rastet e ndëshkueshmërisë në gjykatat shqiptare mbeten në nivele shumë të ulëta, kryesisht për korrupsionin pasiv dhe aktiv të funksionarëve të lartë dhe të të zgjedhurve vendor, ndërsa në nivele akoma më të ulëta për gjyqtarët dhe prokurorët. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë, në harmoni me konventat dhe rekomandimet e ndërkombëtarëve parashikon kriminalizimin e veprave penale të korrupsionit dhe penalizimin e tyre me sanksionet penale, bazuar në parimet e ligjshmërisë dhe të fajësisë, të përgjegjësisë penale, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në luftimin e kriminalitetit.

Shteti Shqiptar ka ratifikuar me ligjin Nr.8778, datë 16.09.2004 Konventën penale “Për korrupsionin” të Këshillit të Evropës, si akti juridik kryesor për veprat penale të korrupsionit, të cilat janë pasqyruar gjithashtu në Kodin tonë Penal. Fillimisht, në mbështetje të Konventës Penale u bënë ndryshimet ligjore të Kodit Penal të vitit 2004, nëpërmjet ligjit Nr. 9275, datë 16.09.2004. Me miratimin e këtij akti u bë unifikimi i terminologjisë me atë të Konventës, duke përfshirë termet “korrupsion pasiv” dhe “korrupsion aktiv”, si dhe u kriminalizuan vepra të reja penale të korrupsionit aktiv e pasiv në sektorin privat (neni 164), korrupsioni aktiv e pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (nenet 244 e 259), korrupsioni i funksionarëve

2 Klodiana Lala, *Reforma në drejtësi përballat me rrethin vicioz të korrupsionit*, Birn Albania <http://www.reporter.al/reforma-ne-drejttesi-perballet-me-rrethin-vicioz-te-korrupsionit/>



të lartë shtetërore dhe i të zgjedhurve vendorë (nenet 245 e 260), korrupsioni aktiv dhe ai pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Vendi ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventat përkatëse të Këshillit të Evropës për luftën kundër korrupsionit dhe Konventën e OECD-së për luftën kundër korrupsionit të nëpunësve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar.

Në mbështetje të Protokollit shtesë të Konventës “Për korrupsionin” dhe të rekomandimeve të grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO), në vitin 2012, nëpërmjet ligjit Nr. 23, datë 1.3.2012, u bënë shtesa e ndryshime të tjera në Kodin Penal, për kriminalizimin dhe penalizimin e veprave penale të korrupsionit aktiv dhe atij pasiv për gjyqtarët e gjykatave ndërkombëtare, jurive, arbitrit të vendit e të huaj (nenet 319/a deri 319/e).

Në vitin 2014, me ndryshimet e fundit që pësoi Kodi i Procedurës Penale, kompetenca lëndore për 4 vepra penale në fushën e korrupsionit, (të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve të lartë, të zgjedhurve vendor, si dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve) kaloi nga njësitë e përbashkëta hetimore në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe më pas gjykimi i këtyre çështjeve penale kaloi në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Zbatimi i plotë në praktikë i legjislacionit, ku të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit mbetet sfida kryesore e të gjitha institucioneve publike, organeve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë këtu edhe institucionet e pavarura në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë, kur shtrohet çështja për zbatimin e legjislacionit që ka si qëllim parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, përgjegjshmëria e institucioneve shtetërore në drejtim të realizimit të përgjegjësiave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre duhet të jetë maksimale. Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreh gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar e dhënë kontributin e tij në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij në të gjithë sektorët, publik dhe privat në vendin tonë.

## 2. Opinion i pavarur për Raportin Studimor

*Nga Av. Arben Rakipi*

Raporti studimor i hartuar nga ekspertët e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përmbledh në analizë veprimtarinë gjyqësore të Gjykatave në rrethet gjyqësore Tiranë dhe Durrës si dhe, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përgjatë viteve 2013-2014. Gjithashtu, pjesë e këtij studimi është edhe analiza e ecurisë së kallëzimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përgjatë vitit 2014. Në lëndë, lidhja e këtyre materialeve është logjike dhe paraqitja e përbashkët e tyre përpara auditorit të profesionistëve apo publikut, synon të qartësojë mekanizmin procedural që përdoret në trajtimin e kallëzimeve penale dhe fatin përfundimtar të tyre.

Fillimisht dua të theksoj se studimi në fjalë duhet veçuar në një element krejt të ri të tij krahasuar me shumë të tjerë të ngjashëm servirur publikut. Ai analizon në shumë momente me frymë kritike vendimet gjyqësore, i vendos ato përballë me ligjin, me praktikën e vetë gjykatës dhe, në ndonjë rast, edhe me vetë konsekuencën e të njëjtit vendim lidhur me të pandehur të ndryshëm. Në këtë pikëpamje pozicionimi i ekspertëve hartues të tij qëndron në nivelin e rishikuesit të vendimit gjyqësor.

Pa shkuar në diskutimin nëse një vendim gjyqësor mund apo jo të diskutohet në elementin e tij bazë, që lidhet me bindjen e brendshme të gjyqtarit dhe pavarësinë e pushtetit të tij apo gjyqësorit në tërësi për të dhënë e rishikuar vendimet gjyqësore, unë them që, nëse specialistët e fushës, ata që shkruajnë kritikën dhe ata të cilëve u drejtohet ajo, do të arrijnë mirëkuptimin se çfarë është shkruar është dhe mbetet vetëm një analizë e thelluar teknike, që ka për qëllim thjesht vetëm të evidentojë defekte të dukshme të vendimit gjyqësor, dhe nuk ka aspak të bëjë me vënien në dyshim, qoftë edhe në mënyre minimale, të pavarësisë së gjyqtarit e gjyqësorit në tërësi; kritika duhet trajtuar me mirësjellje dhe të analizohet vërtetësia e saj. Raporti i vërtetë në gjetjet që ka paraqitur, u shërben shumë edhe atyre që u drejtohet, si dhe transparencës në tërësinë e veprimtarisë gjyqësore.

Nuk është pa vlerë të them se Raporti në mjaft elemente të tij ka shënuar të njëjtat gjetje, ashtu si edhe analiza e sistemit të drejtësisë hartuar nga Komisioni Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Kjo përputhje shton edhe më shumë vërtetësinë e këtij Raporti dhe të besueshmërisë në publik.

Për të kaluar në elementë të veçantë të tij, më bie në sy për t'u përmendur, marrëdhënia e vështirë procedurale mes kallëzuesit, KLSH-së dhe Prokurorisë. Të njëjtën ngjashmëri ruan edhe marrëdhënia ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Përmend këtë fakt për të kuptuar se mungesa e harmonizimit të punës së përbashkët hetimore – ndjekje penale është shndërruar në kulturë ndër institucionet përkatëse dhe nuk lidhet vetëm me organet që përmenden në raport studimor.

Ky konkluzion del i qartë nga statistikat e paraqitura në Raport. Prej kallëzimeve të KLSH-së, akuza ka mundur të kalojë për gjykim vetëm më pak se sa 20 % të tyre, gjithmonë për vitin 2014. Kjo përqindje është shumë më e ulët se sa mesatarja shumë vjeçare e numrit total të çështjeve që i kalojnë gjykatës për gjykim, për shkak të krimeve të kryera. Konkluzioni është i dyanshëm: ose cilësia e kallëzimeve është e ulët, pra e shndërrojnë vetë kallëzimin në fiktiv, ose drejtimi i hetimeve dhe gjithashtu profesionalizmi i prokurorit është i ulët. Ose të dyja bashkë. Pjesa tjetër e kallëzimeve penale janë pushuar apo mos filluar. Raporti gjen më tej se, asnjë prej vendimeve të mos fillimit të hetimeve apo pushimit të tyre nuk janë ankuar në gjykatë prej kallëzuesit të tyre. Nuk ka asnjë të dhënë në materialin në fjalë nëse ankimi është bërë te Prokurori i Përgjithshëm dhe çfarë vendimi eventualisht ka marrë ky i fundit. Ajo që dihet me siguri është që më pak se sa 20 % e çështjeve të tilla kanë shkuar ne gjyq.

Parë në këtë pikë vështrim, duke analizuar shifrat, marrëdhënia hetim-ndjekje penale është shqetësuese. Raporti nuk ka arritur (mbase nuk ka qenë detyrë apo mundësi e tij) të verifikojë çfarë marrëdhënie është zhvilluar përgjatë kohës së hetimeve ndërmjet kallëzuesve ekspertë dhe prokurorit. Kjo analizë do të tregonte, në mundësinë më të madhe, se kujt i duhet vënë gishti si përgjegjës për këtë skarcitet. Gjithashtu, raporti shënon një element të rëndësishëm, që dua të përmend në mbështetje të faktit, sipas të cilit marrëdhënia ndërmjet kallëzuesit dhe prokurorit paraqitet e vështirë. Nuk ka asnjë të dhënë - thotë raporti - që vendimet e prokurorit të jenë komunikuar te kallëzuesi.

Duke parë analizën e Raportit për fatin e këtyre çështjeve gjatë gjykimeve të zhvilluara, gjendet shifra që thotë se më tepër se sa gjysma e të pandehurve të akuzuar në gjyq lidhur me kryerjen e veprave penale objekt i këtij studimi janë deklaruar të pafajshëm ose çështja është pushuar nga gjykatat. Nuk ka të dhëna se si janë përfunduar çështjet në fjalë në gjykatat më të larta në vend. Nëse do i përmbahemi këtij rezultati, me rezervën e sipërpërmendur, atëherë konkluzioni që cilësia e hetimeve është e ulët mbështetet fuqishëm nga kjo e dhënë.

Duke vështruar në tërësinë e elementeve të këtij fenomeni me të cilin janë marrë organet e drejtësisë, që fillon me trajtimin e hetimeve paraprake

prej fazës së kallëzimit penal, por edhe procedurës së zhvilluar në gjykatë, nga shifrat e dhëna në Raport e të analizuar më lart të krijohet përshtypja se, në të përgjithshmen e saj tendenca është drejt kryerjes formale të disa procedurave të ftohta burokratike dhe asgjë më tepër. Nuk gjendet në asnjë rast që subjektet e procedimit, kallëzuesit, të dëmtuarit, etj., të jenë marrë me thelbin e problemit të madh që shkaktohet nga veprimtaria kriminale: dëmi ekonomik i shkaktuar shtetit. Edhe në ato pak raste që janë dërguar në gjykatë, asnjë nuk është marrë me trajtimin e përgjegjësisë civile të personave përgjegjës penalisht.

Raporti, paraqet gjetjen e rëndësishme që lidhet me cilësinë e subjekteve të kallëzuara penalisht. Ai konkludon se niveli i zyrtarëve në hierarkinë e administratës shtetërore është i ulët. Kjo mund të ketë dhjetëra arsye të mira për të ndodhur, por parë nën pikëpamjen statistikore, apo edhe të kuptimit se si funksionon administrata shtetërore në vend, të lë përshtypjen që hetimet e zhvilluara janë jo mjaftueshmërisht të thella.

Në analizën e elementëve të detajuara procedurale, si fjala vjen, koha e përfundimit të gjykimeve, sasia e seancave, afatet e hetimeve etj., raporti konstaton saktësisht të metën e madhe që dihet prej të gjithëve, se gjykimi në sistemin tonë shkon përtej afateve të arsyeshme që një vepër e tillë penale duhet të harxhojë për t'u shqyrtuar. Ndonjëherë, shtrirja në kohë edhe e gjykimit të shkurtuar kapërcen çdo masë dhe humb esencën e vetë këtij instituti. Megjithatë, e rekomandueshme është që të njihen vështirësitë e infrastrukturës që gjykatat posedojnë, jo në përgjithësinë e tyre, por ato që lidhen me rastin konkret. Kjo mund të siguronte pasqyrë të qartë të shkaqeve pse gjykimet tona shtrihen përtej çdo afati të arsyeshëm.

Të njëjtin kujdes kërkon edhe trajtimi i shkaqeve që lidhen me cilësinë e hetimeve, për të evidentuar ku është e meta: te kallëzuesi, te drejtuesi i hetimeve apo te mos koordinimi mes tyre? Po ashtu, elemente të tilla si mënyra e caktimit të masës dhe të llojit të dënimeve penale, deklarimit të fajësisë apo pafajësisë së personave, lidhjes së kohëzgjatjes apo mënyrës së gjykimit me fatin e tij përfundimtar kanë nevojë për mbështetje më të mirë dokumentare.

Në përfundim, ritheksoj se Raporti i paraqitur është rrjedhojë e një pune serioze të ekspertëve të KSHH-së. Ai evidenton të vërteta thelbësore që lidhen me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë, mbarëvajtjes së tij, koordinimit të punëve me institucionet e specializuara të ngarkuara për të trajtuar problematikën e fushës përkatëse. Për më tepër, Raporti sjell të renë e madhe, trajtimin profesional të cilësisë së vendimeve gjyqësore. Të paktën debati që hapet për këtë element është i mjaftueshëm për ta konsideruar Raportin në fjalë si të mirëpritur.

### 3. Përmbledhje ekzekutive

#### 3.1 Ecuria e hetimit të disa kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit

KLSh-ja ka adresuar një numër të konsiderueshëm të kallëzimeve penale për dëme të shkaktuara në buxhetin e shtetit në shuma të konsiderueshme, por në Raportet vjetore nuk rezultojnë të dhëna mbi impaktin që kanë pasur këto kallëzime, ecurinë e hetimit dhe ndëshkueshmërinë e subjekteve ndaj të cilëve është bërë kallëzimi dhe se si ka ndikuar kjo veprimtari e KLSh-së në përmbushje të misionit të saj, sa i takon përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomizim të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, si dhe zhvillimit të një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit.

Pavarësisht deklaratave publike të Prokurorit të Përgjithshëm në mbështetje të punës së KLSh-së, si dhe ushtrimit të ndjekjes penale dhe ngritjes së akuzës në gjyq ndaj të pandehurve të dyshuar si autor/ë të veprës penale, nga buletinet e publikuara të KLSh-së rezulton se të gjitha kallëzimet janë në fazën e hetimit. Këto konstatime, të cilat vlerësojmë se janë burim i fenomenit të pandëshkueshmërisë në vendin tonë, ndeshen edhe për denoncimet e adresuara nga institucione të tjera të kontrollit, sikurse është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

Gjatë mbledhjes së të dhënave për realizimin e studimit të ecurisë së hetimit të kallëzimeve të KLSh-së, në përgjithësi e drejta e informimit është respektuar nga institucionet e kontaktuara, me përjashtim të mungesës së informacionit shtesë mbi mospërputhjen e kopjeve të vendimeve të vëna në dispozicion nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me numrin e kallëzimeve të KLSh-së.

Në çdo kallëzim penal drejtuar prokurorisë, KLSh-ja i referohet nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, duke marrë “rolin” procedural-penal të kallëzuesit, **mbrojtësit të interesit publik** të lidhur me përdorimin konform legjislacionit të buxhetit të shtetit dhe financave publike. U konstatua se, **kallëzimet e KLSh-së nuk përmbanin të dhënat e vendbanimit të të kallëzuarve, si element thelbësor i parashikuar në pikën 3 të nenit 281 të KPrP.**

Të kallëzuarit rezultojnë zyrtarë ose ish zyrtarë të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese, si dhe nëpunës të tjerë ekzekutivë (specialistë dhe

inspektorë) në sektorët të tillë, si: regjistrimi i pasurive të paluajtshme, koncesionet, prokurimet, shëndetit, energjisë elektrike, ofrimit të shërbimeve të tjera publike (ujësjellës, kanalizime, rrugët, shërbimet portuale – doganore, legalizimeve të ndërtesave, etj.).

Të kallëzuarit janë hetuar për konsumimin e elementëve të figurës së veprave penale “Shpërdorim detyrë”, “Shkelje e barazisë në tender apo ankande publike”, “Mashttrim”, “Mashtrimi në sigurime” dhe “Falsifikim dokumentesh”, sanksionuar nga nenet 248, 258, 143, 154 dhe 186 i Kodit Penal (KP). Në disa raste, i njëjti person referohet si i dyshuar për kryerjen e më shumë se një nga këto vepra penale.

Aplikimi i masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur para policisë gjyqësore” ka qenë në numër minimal, vetëm ndaj të pandehurve në 2 çështje të dërguara për gjykim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nëpunësit civilë të hetuar nën këtë masë i përkasin kategorisë “ekzekutive”, specialistë pra, pavarësisht se dëmi ekonomik për të cilën janë kallëzuar dhe hetuar zyrtarët e tjerë, si dhe vepra penale që dyshohet se kanë kryer tregojnë për rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe lidhet me funksione dhe kompetenca vendimmarrëse të subjektit aktiv. Në këto raste, prokuroria ka dërguar çështjen për gjykim. Ndërsa në rastet e pushimit dhe mos fillimit të ndjekjes penale nuk rezulton të jenë aplikuar masa sigurimi personal gjatë fazës së hetimit nga ndonjë hallkë e Prokurorisë.

KShH konstaton se, nga **22 vendimet e analizuara të prokurorive të rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, rezulton se më pak se ¼ e tyre, përkatësisht 6 (gjashtë) çështje në total janë dërguar për gjykim**, 3 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe 3 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në vijim të kallëzimeve të KLSH-së. **Procedimet e tjera në të dy prokuroritë janë pushuar dhe në 1 rast është vendosur mos fillim i ndjekjes penale.**

Në disa raste, kur Prokuroria ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim janë ndryshuar emrat e të akuzuarve, duke rritur numrin e personave të tjerë të dyshuar si të përfshirë në kryerjen e veprave penale, kryesisht nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese apo ekzekutivë (specialistë). Gjatë analizës së vendimeve të prokurorisë rezulton se në rreth **75% të rasteve, organi i ndjekjes penale ka hetuar në mënyrë të detajuar aspektin teknik dhe financiar të çështjes së denoncuar, në frymën e legjislacionit**, veçanërisht bazuar në Kodin Penal. Në disa raste të tjera, kryesisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka munguar analiza ligjore apo financiare, duke iu përshtatur vetëm renditjes së fakteve të pretenduara dhe strukturës së kallëzimit të KLSH-së.



Me përjashtim të vendimit të mos fillimit të ndjekjes penale, në të gjitha vendimet për pushimin e çështjes penale, **Prokuroria shprehet për njoftimin e të interesuarve, pa përcaktuar në mënyrë nominale KLSH,** duke vështirësuar identifikimin e kallëzuesit, çka mund të shkaktojë cënimin e së drejtës për ankim, sipas nenit 329 të K.Pr.Penale.

Në vendimet e studiara të Prokurorisë, **vetëm në rastin e mos fillimit të ndjekjes penale është përcaktuar shprehimisht afati 5-ditor i së drejtës për të paraqitur ankim.** Ndërkohë, **vetëm në 3 vendime pushimi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është shprehur për të drejtën që gëzojnë subjektet për të ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe /ose te Prokurori më i Lartë.**

Në shumicën e kallëzimeve, KLSH ka përcaktuar dëmin ekonomik në buxhetin e shtetit, në një total prej rreth **3,324,403,000 Lekësh.** Nga të dhënat e Buletinit nr.4/2014, rezultojnë **1135 masa administrative të rekomanduara** nga KLSH-ja, prej të cilave janë **zbatuar 64.5%** e tyre. KLSH ka kërkuar **zhdëmtim financiar në vlerën 11,085,084,000 Lekë,** për të cilën është **zbatuar** në masën **34 %**, duke shfaqur domosdoshmërinë e rritjes së impaktit real të veprimtarisë së institucionit në rikuperimin e dëmit apo parandalimin e tij.

Gjatë vitit 2014, mbi 70% e çështjeve janë pushuar apo mos filluar nga prokuroria, kryesisht për shkak të mungesës së elementëve të veprës penale në faktin e kallëzuar, duke nënkuptuar kualifikim jo të drejtë ligjor të rrethanave nga KLSH-ja. Për këto vendime **nuk rezultojnë që KLSH të ketë ushtruar të drejtën e ankimit për pushimin apo mos fillimin e procedimit penal, në gjykatë apo te Prokurori më i Lartë.**

E njëjta praktikë institucionale për mos ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të Prokurorisë rezultojnë edhe për institucione të tjera kontrolli, si p.sh. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

Raportet vjetore të ILDKPKI-së përpara Kuvendit paraqesin **shifra të larta të dëmit ekonomik të shkaktuar nga veprimtaria e paligjshme e zyrtarëve shtetërore.** Rezulton se ka pasur numër të lartë kallëzimesh<sup>3</sup> të kryera nga ky institucion për këto veprime, por **nuk pasqyrohet informacion mbi rastet e ankimit në gjykatë sipas Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P.) ndaj vendimeve të Prokurorisë, të pushimit apo mos fillimit të procedimeve penale**

3 Nga informacioni i dërguar në rrugë elektronike prej ILDKPI, për vitet 2014-2015 rezultojnë 159 kallëzime në total.

Gjejmë rastin të nënvizojmë me nota pozitive faktin, sipas të cilit, reagimet e herëpashershme të KShH-së për mos ushtrimin e së drejtës së ankimit nga këto institucione, të cilat janë adresuar edhe gjatë takimeve që janë zhvilluar me përfaqësues të KLSH-së, duket se kanë gjetur pasqyrim në veprimtarinë e këtij të fundit. Konkretisht, nga të dhënat në Buletinin të KLSH nr.1/2016 në lidhje me kallëzimet penale që ka adresuar në Prokurori, **KLSH-ja reflekton ndryshim pozitiv**, pasi gjatë periudhës Janar-Prill 2016 ka ushtruar ankim në gjykatë dhe te Prokurori i Përgjithshëm, për kallëzimet e bëra gjatë vitit 2015. Impakti pozitiv i nismës së KShH-së vërehet edhe në këto drejtime:

*Së pari*, në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të shtetit për vitin 2015”, e miratuar nga Kuvendi në datën 20 Tetor 2015, ky i fundit rekomandon se “KLSH-ja duhet të angazhohet për të rritur bashkëpunimin institucional me Prokurorinë e Përgjithshme, nëpërmjet monitorimit të ecurisë së padive penale dhe të zhvillojë një analizë fundore të saj në rastet e pushimit të çështjeve ose mos fillimit të çështjeve të referuara nga KLSH-ja në organin e akuzës. Kjo do të shërbejë për të kryer një analizë përfundimtare më të plotë, si dhe kontrollin e cilësisë së vetë raporteve të auditimit”.

*Së dyti*, Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar rekomandimin e përcjellë nga KShH mbi praktikën e mos ushtrimit të së drejtës së ankimit për një institucion tjetër të pavarur si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit. Në rezolutën për miratimin e raportit vjetor të ILDKPKI për vitin 2015, Kuvendi i rekomandon këtij institucioni të ushtrojë të drejtën e ankimit, përfshirë ankimin administrativ dhe gjyqësor, ndaj vendimeve të mos fillimit apo pushimit të prokurorisë për kallëzimet penale të përcjella nga ky institucion.

*Së treti*, vlen të theksohet se **KLSH ka pasqyruar ndryshim pozitiv në paraqitjen e të dhënave në Buletinin nr.1/2016 në lidhje me kallëzimet penale që ka adresuar në prokurori.** Gjatë periudhës Janar-Prill 2016, KLSH ka adresuar 7 kallëzime penale për 31 drejtues të mesëm e të lartë të Autoritetit Rrugor Shqiptar, QSUT-së, ZVRPP Tiranë e Shkodër dhe Ujësjellës kanalizime sh.a. Pogradec. Në *Formularin 5* bashkëlidhur këtij Buletini rezultojnë se të gjitha kallëzimet janë në hetim, ndërsa në *Formularin 5.1* dhe *5.2* paraqiten evidenca të kallëzimeve penale të ankimuara në gjykatë dhe tek Prokurori i Përgjithshëm, duke përbërë një risi në praktikën institucionale të KLSH. Kallëzimet i përkasin vitit 2015, ndërsa ankimet ndaj vendimeve të pushimit janë realizuar në vitin 2016. Në total, rezulton se KLSH ka paraqitur 9 ankime, përkatësisht 4 ankime në rrugë gjyqësore dhe 5 në Prokurorinë e Përgjithshme, duke zbatuar në të njëjtën mënyrë nenin 24/5 dhe 329/1 të KPrP.



*Së katërti*, KLSH ushtroi në fillim të muajit Tetor të këtij viti, të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit për pushimin procedimit penal të Prokurorisë ndaj dy zyrtarëve të lartë publikë të denoncuar lidhur me negociatat për marrëveshjen mes kompanisë ÇEZ dhe shtetit shqiptar. KShH vlerëson me nota pozitive faktin që KLSH e ushtroi të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj dy zyrtarëve të nivelit të lartë, por ndërkohë ky vlerësim i yni nuk shtrihet mbi thelbin e çështjes, për të cilin të drejtën për t'u shprehur me vendim përfundimtar e ka vetëm gjykata.

### 3.2 Gjetjet lidhur me monitorimin e disa seancave gjyqësore

Gjatë monitorimit të 53 seancave gjyqësore për çështjet penale të korrupsionit ka rezultuar se, **12** seanca kanë filluar në kohën e paracaktuar (më pak se 23%) ndërkohë që **41** kanë filluar me vonesë (mbi 77 % e totalit). Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda është institucioni ku respektohet më shumë orari i çeljes së seancave gjyqësore. Intervalet kohore të vonesave kanë rezultuar nga **3 minuta minimalisht**, deri në **23 minuta maksimalisht**, për shkak të mbivendosjes së seancave gjyqësore me të njëjtin trup gjykues.

**87 % e seancave gjyqësore** të monitoruara janë zhvilluara në sallë, ndërsa 13% e tyre janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve. Seancat gjyqësore të zhvilluara në zyrat e gjyqtarëve i përkasin Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në rreth **94 % të rasteve** nuk ka pasur pengesa në monitorim, ndërsa vetëm në **3 raste**, pavarësisht se monitoruesit e KShH-së janë lejuar të vëzhgojnë, ata kanë hasur paraprakisht në vështirësi, veçanërisht në hyrje të gjykatës, ku janë pyetur nga punonjës sigurie për arsyen e hyrjes në godinë, janë kontrolluar imtësisht apo kanë përcaktuar vendin e qëndrimit të monitoruesit, pavarësisht se në sallë ka pasur vende të lira mjaftueshëm për të ndjekur zhvillimin e seancës gjyqësore. Kjo ka ndodhur kryesisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.

KShH ka konstatuar se, vetëm në rreth **7.5% të rasteve përfaqësuesi i prokurorisë nuk ka mbajtur veshjen e posaçme** ndërsa gjykata në **28 % të seancave** ka shkelur këtë aspekt të solemnitetit të gjykimit. Avokatët mbrojtës kanë treguar më shumë rregullësi në këtë drejtim. Ndërkohë, në **92.5 % të rasteve** është respektuar etika e komunikimit nga pjesëmarrësit në gjykimin penal.

Nga monitorimet e zhvilluara nuk ka rezultuar që një trup gjykues të ketë shfaqur njëanshmëri për ndonjë nga palët në proces gjykimi, si dhe rezulton të jetë respektuar paanshmëria objektive, pra nuk ka pasur

tregues apo shenja që të evidentojnë kompromise të dukshme midis të tre subjekteve të procedimit penal: gjykatës, prokurorisë dhe të pandehurit.

**Kohëzgjatja mesatare e gjykimit** ka qenë rreth **138 ditë**, ku më e larta është konstatuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda me **kohëzgjatje mesatare prej 169 ditë**. Shkak i ndërprerjes dhe shtyrjes së seancave gjyqësore ka rezultuar mungesa e përfaqësuesit të prokurorisë, mungesa e të pandehurit apo mbrojtësit të tij, mungesa e anëtarëve të trupit gjykues për formimin e kuorumit të nevojshëm, koha e kërkuar nga prokurori apo avokati mbrojtës për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare, mos njoftimi efektiv i dëshmitarëve të thirrur në gjykim, si dhe nuk kanë munguar rastet e shtyrjeve për shkak të mbarimit të orarit zyrtar, mungesa e ekspertëve apo përkthyesve, nevoja për riformulim e kërkesës për gjykim, etj.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, për **50 %** e të pandehurve është caktuar masa e "*arrestit në burg*", ndërsa në gjykatat e tjera të rreth **56 %** e të pandehurve janë gjykuar në gjendje të lirë.

Referuar kategorizimit të parashikuar në Ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, rreth **80 %** e të pandehurve të punësuar në sektorin publik u përkasin pothuajse në të gjitha rastet nivelit të ulët drejtues dhe ekzekutiv (specialistë). Të pandehurit u përkasin fushave të ndryshme të shërbimeve publike, si në shërbimet doganore, policinë rrugore, shërbimin mjedisor, energjetike, drejtësi, etj. 3 të pandehur janë në radhët e sistemit të drejtësisë, konkretisht 1 gjyqtar dhe 2 prokurorë.

Akuzat për korrupsionin e të pandehurve kanë pasur objekt material *paratë*, që arrijnë vlera relativisht të larta deri rreth 30,000 Euro, me qëllim për të ndikuar në vendimmarrjen e zyrtarëve të administratës publike, duke përfshirë prokurorë dhe gjyqtarë, në favor të shtetasve privat.

Gjatë monitorimit është konstatuar ndjekja e politikës së ngjashme penale nga Prokuroria dhe gjykatat, veçanërisht ato për Krimet e Rënda. Masat e dënimit me burgim në kufijtë e minimumit, ose mesatares së parashikuar nga Kodi Penal. Në çështjet që kanë rezultuar me vendim fajësie, është zbatuar gjykimi i shkurtuar, i cili ka ulur në disa raste masën e dënimit nën minimumin e parashikuar në ligj.

### 3.3 Gjetjet lidhur me analizën e disa vendimeve gjyqësore

Kampioni i vendimeve gjyqësore që janë objekt i këtij raporti studimor përfshin një total prej 48 vendimesh, ku janë gjykuar në cilësinë e të

pandehurit 97 persona. Vendimet gjyqësore të studiuara i përkasin më shumë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga kampioni i vendimeve gjyqësore të studiuara, rezulton se tendenca e gjykatës është të mos paraqesë një tablo të përmbledhur të çështjes së gjykuar dhe në mënyrë të veçantë të rrethanave procedurale të çështjes, rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në gjykim, analizës ligjore të provave dhe pretendimeve të palëve në proces, etj. Vihet re se gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda kanë shkruar vendime më të plota dhe më të arsyetuara në raport me vendimet e gjykatave të tjera. Kjo mund të vijë edhe për shkak të ngarkesës më të lartë të këtyre të fundit.

Masat shtrënguese, të cilat janë zbatuar ndaj të gjithë të pandehurve të akuzuar për korrupsion dominohen nga masa e “arrestit në burg”, dhe me radhë kjo masë pasohet nga “arresti në shtëpi”, masa shtrënguese të alternuara ose garanci pasurore. Masa e sigurimit më pak e aplikuar është “detyrimi për paraqitje”. Rezultojnë të pa aplikuar masat e tjera shtrënguese të parashikuara nga neni 232 i K.Pr.P., përkatësisht “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, “ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar”, “shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”.

Kallëzimet kryesisht bëhen nga personat e dëmtuar. Përgjithësisht, cilësia e kallëzimeve ose referimeve të veprave penale të korrupsionit është e ulët. Në një sërë procedimesh penale, subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal kanë qenë persona të cilëve iu është mohuar një e drejtë e parashikuar nga ligji dhe i kërkohet të paguajë për ushtrimin e kësaj të drejte. Në një numër vendimesh rezulton se, kallëzimi bëhet kur i dëmtuari dhe i pandehuri nuk bie në marrëveshje për vlerën e shpërblimit ose kur janë në pamundësi financiare për ta shlyer atë. Ka raste kur i dëmtuari e ka bërë kallëzimin pasi ka shlyer pjesërisht një pjesë të përfitimit material të veprës penale, ndërkohë që subjektet e veprës kanë kërkuar pagimin e një shume më të madhe.

Numri i të pandehurve të gjykuar me gjykim të shkurtuar për veprat penale objekt i këtij raporti studimor është në numër të konsiderueshëm. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezultoi se në rreth 69% të gjykimeve (duke përfshirë këtu edhe rastet e disa të pandehurve në gjykim) është proceduar me gjykimin e shkurtuar, i cili sipas Kodit të Procedurës Penale është gjykim i posaçëm. Ekspertë të fushës referojnë se në shkallë vendi, gjykimi i shkurtuar zbatohet për 80 % të çështjeve penale dhe ajo që rezulton më së shumti në këto procese është se cilësia e hetimit nuk është në nivelin e duhur. Rrjedhimisht, kjo cilësi prek edhe provat e siguruara gjatë hetimit, tek të cilat gjykata duhet të mbështetet në dhënien e vendimit. Statistikat dhe praktika hetimore dhe gjyqësore ka diktuar nevojën për

ndryshime në legjislacionin tonë procedural, me qëllim që të përjashtohen nga gjykimi i shkurtuar disa persona ose vepra penale me rrezikshmëri të lartë duke mos i lënë diskrecion të gjerë gjykatës.

Proceset gjyqësore penale për veprat e korrupsionit në disa raste zhvillohen tej afateve mesatare të parashikuara për gjykimin e çështjeve të tilla. Nga studimi i kalendarëve të çështjeve penale të korrupsionit, për një kampion prej 15 vendimesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 3 vendimesh të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda rezulton se në 73 seanca gjyqësore, shtyrja dominohet nga shkaqe të lidhura me mungesën e prokurorit apo kërkesat e tij për shtyrje. Në disa çështje, rezulton se prokurori mungon në gati gjysmën e seancave gjyqësore. Në 51 raste shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe të lidhura me avokatët mbrojtës të të pandehurve. Në 49 raste shkak ka qenë mungesa e të pandehurit dhe kërkesës së tij, etj. KShH vlerëson se, organi i akuzës nuk duhet të jetë shkak për shtyrje në një numër kaq të konsiderueshëm të seancave gjyqësore. Këto çështje kanë ndjeshmëri të lartë dhe prokuroria ka detyrimin të respektojë ligjin dhe mos zvarritur seancat gjyqësore. Gjithashtu, vlerësojmë se prokuroria ka dhe detyrimin pozitiv të marrë masa efektive të organizimit të brendshëm, me qëllim që gjykimi të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë dhe seancat të mos shtyhen edhe kur prokurori ka arsye objektive për të mos u paraqitur, siç mund të jetë ngarkesa e punës. Gjykata duhet të jetë gjithashtu aktive në disiplinimin e palëve në proces, duke shmangur çdo zvarritje të qëllimshme të mbrojtësit dhe të të pandehurit.

Kryesisht provat e referuara në vendim për të provuar fajësinë e të pandehurve janë ato të marra nëpërmjet përgjimit në ambiente publike, përgjimit të telefonatave, përgjimeve të fshehta fotografike, filmime ose me video, kryerjes së veprimeve simulative, ushtrimit të kontrollit personal, të kontrollit të banesës.

Në disa prej vendimeve gjyqësore, rezulton se provat e siguruara gjatë procesit hetimor dhe të administruara gjatë gjykimit janë kontestuar për shkak të vlefshmërisë së tyre. Gjykata ka çmuar se rezultatet e këtyre provave janë të papërdorshme me arsyetimin se janë marrë në kundërshtim me ligjin. Deklarimi i provave të siguruara gjatë hetimit si të papërdorshme në disa nga vendimet objekt i këtij raporti studimor, vë në pikëpyetje cilësinë e hetimeve të veprave penale në fushën e korrupsionit. Gjykata në vendime të caktuara shpreh haptazi paligjshmërinë e marrjes së provave gjatë fazës së hetimeve të bëra nga prokuroria, duke përdorur si burim informacioni aktet e vetë organit të prokurorisë, ku në vendimin për delegimin e kompetencave të prokurorit është konkluduar se të tre aktet korruptive të kryera për një çështje penale janë të provokuara.

Vërehet se nuk ka një qëndrim të unifikuar të gjykatës sa i takon përdorimit të rezultateve të provave të marra nëpërmjet përgjimit, edhe kur ky është lejuar me vendim të organit procedues. Gjykata në këto raste nuk ka bërë deponime të kundërta sa i takon ligjshmërisë së këtyre përgjimeve por ka konkluduar se nga përgjimet nuk dalin mjaftueshëm fakte që të provojnë kryerjen e veprës penale nga të pandehurit. Sërish kjo vë në pikëpyetje cilësinë e hetimeve. Megjithatë në një rast, ekspertët e KShH-së kanë vërejtur se faktet dalin qartazi nga transkriptet e përgjimeve të cituara në vendimin gjyqësor.

Ka përfunduar me pafajësi çështja penale në ngarkim të një gjyqtari të akuzuar për korrupsion pasiv, ndërkohë që perceptimet dhe ndjeshmëritë e qytetarëve për korrupsionin në radhët e tyre dhe pandëshkueshmërinë e tyre vlerësohen si të larta. Gjykata në këtë çështje kundërshton provat e paraqitura nga prokuroria si përgjime të cilat janë jo procedurale, nuk janë bërë me vendim të organit procedues dhe nuk mund të konsiderohen gjithashtu as prova jo tipikë, pasi nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 151/3 të K.Pr.P. Edhe kjo çështje shtrон nevojën e kryerjes së hetimeve më të plota, efektive dhe të gjithanshme nga organi i akuzës.

Në disa raste gjykata nuk merr në analizë as në mënyrë të përmblëdhur provat mbi të cilat mbështeten faktet e referuara në vendimin gjyqësor, duke u mjaftuar në disa raste me citimin e provave shkresore dhe procesverbalet e deklaratave të shtetasve të pyetur nga prokuroria, pa bërë referime të fakteve mbi të cilat hedhin dritë këto prova. Në një çështje, mënyra se si është bërë arsyetimi i provave të administruara në këtë proces gjyqësor, duke cituar faktet që rezultojnë vetëm ato të transkripteve të bisedave të përgjuara dhe jo faktet që burojnë nga provat e tjera të administruara në proces, nuk përçon tek publiku dhe profesionistët e së drejtës, bindjen sa i takon paanshmërisë së trupit gjykues. Gjithashtu, po në këtë vendim, mbi të njëjtat prova mbi të cilat organ i prokurorisë akuzon 4 prej të pandehurve për korrupsion aktiv të punonjësve që ushtrojnë funksione publike, shpërdorim detyre dhe kontrabandë me mallrat për të cilat paguhet akcizë, Gjykata çmon se vetëm dy prej këtyre të pandehurve gjenden fajtorë për veprën penale të kontrabandës. Pa dashur të shprehemi mbi drejtësinë ose jo të këtij vendimi, atribut i cili i takon vetëm një gjykate më të lartë, dëshirojmë të ngremë si shqetësim për pikëpyetjet që i lindin publikut për respektimin e parimit të barazisë para ligjit nga gjykata.

Analiza e vendimeve evidenton se në të shumtën e rasteve argumentet ligjore të mbrojtësit të të pandehurit dhe organit të akuzës pasqyrohet në vendimet gjyqësore të studiuara. Megjithatë, në disa nga këto vendime, pasqyrimi i argumenteve nuk bëhet në mënyrë të plotë, por përmbledhet shkurtimisht dhe mungon arsyetimi se përse gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.

Në disa raste vihet re se gjykatat nuk kanë një kuptim të drejtë të elementëve të figurës së veprave penale në fushën e korrupsionit. Raste të tilla krijojnë lëkundje të besimit të publikut dhe në mënyrë të veçantë të ekspertëve të ligjit sa i takon parimit të paanshmërisë së trupit gjykues. Gjithashtu janë vërejtur edhe vendime gjyqësore, në të cilat, mënyra se si bëhet analiza nëse ka ose jo vepër penale nuk i përgjigjet plotësisht elementeve të figurës së veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar.

Referuar një vendimi të Gjykatës së Krimeve të Rënda, vlerësojmë se vlen të diskutohet më gjerë nevoja për saktësimin ose qartësimin e subjekteve të posaçëm të parashikuar në nenin 319/ç të Kodit të Procedurës Penale që sanksionon korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Konkretisht, cili do të konsiderohet funksionar i organeve të drejtësisë?

Funksionarët apo zyrtarë të lartë publikë ose funksionarë të sistemit të drejtësisë, edhe në ato raste të pakta kur deklarohen fajtor marrin dënime minimale, për të cilat urdhërohen nga gjykatat pezullimi i ekzekutimit të tyre. Politika penale ndaj funksionarëve të lartë të cilët akuzohen për veprat penale të korrupsionit paraqitet e ndryshme në vendime të gjykatave të ndryshme.

Të dhënat e analizuara evidentojnë se, për veprat penale të korrupsionit në sektorin publik është aplikuar dënimi me burg ndaj 26 të pandehurve, si dhe dënimi me gjobë dhe burg ndaj 3 të pandehurve të deklaruar fajtorë. Në asnjë rast nuk është aplikuar maksimumi i dënimit, ndërkohë që në shumicën e vendimeve janë aplikuar kufijtë minimalë të dënimit penal kryesor. Vlen të theksohet se, nga 25 të pandehur të dënuar me burg, rreth 90% e tyre kanë përfituar nga ulja e 1/3 së dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar. Kryesisht dënimet alternative aplikohen në ato raste kur ka kërkesë nga Prokuroria dhe ka gjithashtu gjykim të shkurtuar. Përkatësisht, rreth 50% e të dënuarve me burg kanë përfituar nga dënimi alternativ i parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal "Pezullimi i Ekzekutimit të Dënimit me Burgim dhe vënia në provë". Vetëm në gjysmën e rasteve kur është dhënë ky dënim alternativ, rezulton që gjykata të jetë disponuar paralelisht me dhënien e detyrimeve që i dënuari duhet të respektojë gjatë kohës së provës, të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Tendenca e Gjykatave të Apelit është të mos e ndryshojë vendimin e dhënë nga Gjykatat e Shkallës së Parë. Edhe në ato pak raste kur ndryshohet ky vendim, dënimi i dhënë ulet akoma më shumë, në mënyrë të veçantë për subjektet e posaçme të veprës penale që mbajnë funksione të larta ose të rëndësishme publike (gjyqtarë). Vetëm në 15% të rasteve, paralelisht me dënimin alternativ është dhënë edhe një dënim plotësues si "Ndalimi i të



drejtës për të ushtruar funksione publike” dhe “Heqja e të drejtës për të ushtruar funksione publike”.

Në llojin dhe masën e dënimit për veprat penale në fushën e korrupsionit, gjykata merr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë e të pandehurit, shkallën e fajit, pranimin e akuzës dhe të fajësisë nga i pandehuri, kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, rrethanat lehtësuese të parashikuar nga nenin 48/ç i Kodit Penal, gjendjen ekonomike dhe familjare, mënyrën e jetesës dhe të nevojave, moshën, pasojën dhe dëmin e ardhur si rezultat i përfitimit në mënyrë të kundërligjshme, si dhe kryerjen e veprës me dashje. Në disa vendime gjyqësore, vërehet se elementët që kanë lidhje me gjendjen ekonomike dhe familjare nuk analizohen në vendim dhe nuk referohen provat të cilat provojnë ekzistencën e tyre.

Në shumicën e vendimeve nuk merret parasysh dhe as nuk argumentohet si element në caktimin e masës së dënimit, pasoja dhe dëmi i ardhur apo vlera e shpërblimit ose përfitimi që ka marrë i pandehuri, kryesisht si rezultat i korrupsionit pasiv. Në disa vendime vërehen vlera relativisht të vogla përfitimi. Ajo që evidentohet në vendime të ndryshme është se nuk ka proporcionalitet midis masës së dënimit dhe vlerës së mitës që është marrë/dhënë nga i pandehuri. Madje në disa raste, persona që janë dënuar për korrupsion pasiv për shuma relativisht të ulëta në të holla dënohen njësoj si persona që korruptohen në vlera të konsiderueshme.

Në vendimet e studiuara ka rezultuar se kryesisht Gjykata ka tendencën të japë të njëjtën masë dënimi të kërkuar nga prokuroria dhe kjo vërehet më së shumti në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Praktika e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në gjykimin e atyre veprave penale në fushën e korrupsionit që ka në kompetencë lëndore, është më e unifikuar sa i takon ndëshkueshmërisë, caktimit të dënimeve duke përfshirë këtu edhe ato plotësuese, si dhe analizës më të plotë që reflektohet në këto vendime. Bazuar edhe në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, në vendimet e studiuara rezultojnë të dënuar funksionarë të lartë të qeverisjes vendore, gjyqtarë dhe avokat.



## **4. Analizë mbi ecurinë e kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës**

### **4.1 Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur**

KShH analizoi **veprimtarinë e KLSH-së në trajtimin dhe kallëzimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit apo shpërdorimit të detyrës nga zyrtarë shtetërorë gjatë vitit 2014**, si dhe hetimin e këtyre kallëzimeve nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës.

*Qëllimi* i kësaj analize është adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve përsa u takon praktikës së kallëzimeve të KLSH-së dhe hetimit të tyre nga organi i Prokurorisë në dy rrethet më të rëndësishme gjyqësore, për çështjet penale të lidhura me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës, duke synuar rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve të kontrollit dhe prokurorisë si dhe rritjen e besimit të publikut, në luftën kundër këtij fenomeni.

*Objekti* i kësaj analize janë kallëzimet penale të KLSH-së drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës gjatë vitit 2014, për veprat penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës apo të ngjashme me to si dhe ecuria e hetimit dhe e gjyqimit të këtyre kallëzimeve nga prokuroritë/gjykatat përkatëse. Në këtë analizë trajtohen aspektet teorike dhe praktike të legjislacionit proceduralo-penal lidhur me kallëzuesin, hetimin, vendimmarrjen e prokurorisë dhe ankimin ndaj tyre, duke synuar evidentimin e praktikave të cilat nuk janë të unifikuara, paraqesin mangësi, nuk janë kryer konform legjislacionit ose mund të përbëjnë shkak për ekzistencën e fenomenit të pandëshkueshmërisë.

*Metodologjia* e ndjekur për realizimin e Raportit, është shtrirë në disa drejtime, duke synuar marrjen dhe kryqëzimin e informacionit në mënyra dhe nga burime të ndryshme.

*Së pari*, është ngritur grupi i punës përgjegjës për realizimin e këtij raporti, i përfaqësuar nga stafi i KShH-së. Fillimisht grupi i punës përcaktoi nevojat dhe drejtimit kryesore ku duhej të përqendrohej puna për realizimin e studimit, gjetjet e të cilit janë evidentuar në këtë raport analitik.

*Së dyti*, janë zhvilluar takime, si dhe është mbajtur komunikim zyrtar me përfaqësues të KLSH-së, Prokurorisë së Përgjithshme, drejtues dhe përfaqësues të organit të Prokurorisë dhe gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, si dhe me përfaqësues të ILDKPKI-së. Gjithashtu, me disa nga këto institucione, korrespondenca zyrtare është mbajtur me shkresa zyrtare ose në rrugë elektronike, si dhe u janë dërguar kërkesa për informacion, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.

Ndonëse në disa raste u përballëm me vonesa dhe vështirësi në mbledhjen e të dhënave, KSHH vlerëson mbështetjen e institucioneve të përfshira në këtë analizë, në ofrimin e informacioneve të kërkuara konform legjislacionit në fuqi.<sup>4</sup>

*Së treti*, pas mbledhjes së materialeve dhe informacioneve zyrtare, u përcaktuan në terma më konkretë çështjet kryesore ku do të fokusohet analiza, baza ligjore si dhe struktura e raportit. Mbledhja dhe përpunimi i këtij informacioni u bazua në një shqyrtim dhe analizë të kujdesshme krahasimore, profesionale, objektive dhe të paanshme. Në fokus të veçantë të kësaj analize janë praktikatat e diskutueshme të KLSH-së dhe Prokurorisë.

Konkretisht, grupi i punës analizoi Buletinet e vitit 2014 të KLSH-së, 25 kallëzime penale të KLSH-së, 22 vendime të Prokurorive në Tiranë e Durrës, si dhe të dhënat e dërguara nga gjykatat e Shkallës së Parë Tiranë e Durrës.

## 4.2 Analizë e përgjithshme

Nga të dhënat e Buletinit të Auditimeve Nr.4/2014 të KLSH<sup>5</sup>, rezultojnë 160 auditime të përfunduara dhe të evaduar të institucionit për vitin 2014. Bazuar në rezultatet e këtyre auditimeve, KLSH ka përcjellë 41 kallëzime penale në total pranë organit të prokurorisë, kryesisht për veprat penale: "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike". Në këto kallëzime denoncohen 149 subjekte, të cilët dyshohet se kanë shkaktuar dëm në total prej 5,069,494,000 Lekësh.

Kallëzimet që janë në kompetencën territoriale të **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës** përbëjnë rreth 61% të numrit total

4 Pas reagimit publik të KSHH, KLSH ka dërguar menjëherë informacionin me kallëzimet penale përkatëse, duke demonstruar vullnet pozitiv në realizimin e këtij Raporti. [http://ahc.org.al/web/images/deklarata/al/VITI\\_2016/Deklarate\\_Zbatimi\\_i\\_ligjit\\_eshte\\_i\\_detyrueshem\\_per\\_te\\_gjithe.pdf](http://ahc.org.al/web/images/deklarata/al/VITI_2016/Deklarate_Zbatimi_i_ligjit_eshte_i_detyrueshem_per_te_gjithe.pdf)

5 [http://www.klsh.org.al/web/Buletini\\_Auditimeve\\_80\\_1.php?kc=0,1,1,0,0](http://www.klsh.org.al/web/Buletini_Auditimeve_80_1.php?kc=0,1,1,0,0)

të kallëzimeve. Për këto kallëzime referohet një **dëm total në vlerën 3,324,403,000 Lekë**, i cili përbën **rreth 65.6 %** të dëmit ekonomik të evidentuar në të 41 kallëzimet së bashku.

Në këtë Buletin konstatohet se KLSH-ja ka kallëzuar në total 86 zyrtarë publikë, nga të cilët **43** shtetas vetëm për veprën penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP), **22** shtetas për veprat penale "Shpërdorim detyre" dhe "Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike" së bashku, të parashikuara nga nenet 248 dhe 258 të KP, **18** shtetas për veprat penale "Mashttrim" dhe "Falsifikim të dokumenteve" së bashku, parashikuar nga nenet 143 dhe 186 të KP, **2** shtetas vetëm për veprën penale "Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike" parashikuar nga neni 258 i KP, si dhe **1** shtetas për veprat penale "Shpërdorim detyre" dhe "Shpërdorim të kompetencave" së bashku, të parashikuara në nenet 248 dhe 164 të KP. Numri i **zyrtarëve publikë** të kallëzuar gjatë 2014 përbën **rreth 57.7 % të totalit** të personave të kallëzuar për këtë vit.

Referuar kategorizimit dhe klasifikimit të parashikuar në nenin 19 të Ligjit Nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, të kallëzuarit rezultojnë kryesisht zyrtarë ose ish zyrtarë të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese, si dhe nëpunës të tjerë ekzekutivë (specialistë dhe inspektorë) në sektorët të tillë si, regjistrimi i pasurive të paluajtshme, koncesionet, prokurimet, shëndetësia, energjia elektrike, ofrimi i shërbimeve të tjera publike (ujësjellës, kanalizime, rrugët, shërbimet portuale - doganore, legalizimeve të ndërtesave, etj.).

Në vitin 2014, KLSH i ka dërguar 25 kallëzime penale Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (19 kallëzime) dhe Asaj Durrës (6 kallëzime). Lidhur me kallëzimet e dërguara pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo e fundit ka vënë në dispozicionin tonë vetëm 16 vendime. Disa prej vendimeve të pushimit apo mos fillimit të prokurorisë i përkasin vetëm një kallëzimi dhe për 7 prej kallëzimeve të KLSH-së nuk u bë e mundur studimi i vendimit përkatës i prokurorisë, për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm.

Të dhënat në Buletinin nr. 4/2014 të KLSH-së, evidentojnë faktin se të gjitha kallëzimet rezultojnë në fazën e hetimeve paraprake. Ky konkluzion është ballafaquar edhe me të dhënat zyrtare të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, në përgjigje të kërkesës së KSHH-së, respektivisht nëpërmjet shkresës Nr. 6098/1 Prot., dt.12.05.2016 dhe Nr. 1337 Prot., dt. 04.05.2016. Në këtë komunikim zyrtar nuk ka rezultuar të jetë paraqitur ndonjë ankim në gjykatë ndaj vendimeve përkatëse të pushimit apo mos fillimit nga prokuroria.

Nga studimi dhe analiza e informacioneve dhe materialeve të vëna në dispozicion nga KLSH, Prokuroritë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës ka rezultuar se, të gjitha kallëzimet e KLSH drejtohen në prokuroritë përkatëse dhe për dijeni Prokurorit të Përgjithshëm. Baza ligjore e kallëzimit është neni **281 i Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P.)** ku përcaktohet detyrimi për kallëzim i nëpunësit publik, nëse gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve apo të shërbimit të tij/saj, merr dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht. Gjithashtu në këtë nen parashikohet se, kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën veprë penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori.

Kallëzimet e KLSH-së janë në formë shkresore dhe përmbajnë lëndën, prokurorinë që i drejtohet, gjeneralitetet dhe funksionin zyrtar të të kallëzuarve, rrethanat dhe elementët thelbësorë të faktit që konsiderohet veprë penale nga KLSH-ja, burimet e provës, si dhe përcaktimin e veprave penale duke cituar numrin dhe titullin e dispozitës konkrete. Megjithatë për aq sa referohet në këto kallëzime, mungojnë **të dhënat e vendbanimit të të kallëzuarve**, ndërkohë që sipas nenit 281/4 të Kodit të Procedurës Penale kërkohet që kallëzimi të përmbajë banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit që i atribuohet fakti.

### 4.3 Analizë për çështje të veçanta

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, gjatë vitit 2014 janë referuar 6 kallëzime penale nga KLSH<sup>6</sup>. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2014 janë marrë 16 vendime penale ndaj kallëzimeve të KLSH<sup>7</sup>. Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka fokusuar analizën në këto elemente të praktikës së denoncimeve të KLSH-së dhe praktikës hetimore të Prokurorisë, në vijim të këtij paragrafi.

- a) *Analiza dhe përmbledhja e shkaqeve të mos fillimit, pushimit, ose dërgimit për gjykim të çështjeve të kallëzuara nga KLSH*

Në Kreun VIII të K.Pr.P. parashikohet faza e përfundimit të hetimeve paraprake nga organi i Prokurorisë, në të cilën mund të vendoset pushimi i çështjes apo dërgimi i çështjes në gjykatë.

<sup>6</sup> Shkresë Nr. 993/1 Prot, dt. 12.02.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës

<sup>7</sup> Shkresë Nr. 200/1 Prot, datë 19.02.2016 të Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria Task - Forcë

Në nenin 328 të këtij Kodi parashikohet se: “1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

Nga studimi i kryer rezulton se, Prokuroria në Rrethin Gjirokastrë Durrës ka pushuar 3 çështje dhe ka dërguar për gjykim 3 çështje të tjera për 6 kallëzimet e bëra nga KLSH gjatë vitit 2014.

Në 3 çështjet e pushuara, Prokuroria në Rrethin Gjirokastrë Durrës ka analizuar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit të kallëzuar nga KLSH-ja, dokumentacionin apo deklaratimet e administruara gjatë hetimit, në aspektin teknik, ligjor dhe financiar, duke i ballafaquar me legjislacionin, respektivisht, mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, lirinë e pjesëmarrjes së shtetasve në një procedure konçensionare, etj. Për këto çështje, Prokuroria ka konkluduar se, **nuk janë konsumuar elementët objektivë dhe subjektivë të veprave penale** të parashikuara nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal. Sipas Prokurorisë, fakti i kallëzuar nga KLSH-ja dhe i hetuar nuk përbën vepër penale, duke qenë në kushtet e gërmës “b”, të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtij organi, punonjësit e administratës publike të kallëzuar nga KLSH-ja kanë vepruar në përputhje me parashikimet ligjore, sipas vendimeve të pushimit të çështjeve nga Prokuroria.

Në 3 çështjet e tjera, Prokuroria në Rrethin Gjirokastrë Durrës ka dërguar për gjykim personat e kallëzuar nga KLSH-ja apo të dyshuar gjatë hetimit, sipas nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale. Nga analiza e fakteve, rrethanave, si dhe veprimeve apo mosveprimeve konkrete të të pandehurve në raport me elementët e figurës së veprave penale, Prokuroria ka konstatuar në këto tre çështje konsumimin e anës objektive dhe subjektive të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, ose “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal, duke argumentuar gjerësisht aspektin teknik e financiar të rrethanave. Në procedimin penal Nr. 259, të vitit 2012, ku është përfshirë edhe një kallëzim i paraqitur nga KLSH-ja gjatë vitit 2014, Prokuroria ka dërguar për gjykim vetëm 4 nga 7 persona të kallëzuar nga KLSH-ja, ndërsa në procedimin penal Nr. 1785, të vitit 2014 janë dërguar për gjykim 4 të pandehur, pavarësisht se KLSH-ja ka kallëzuar vetëm 1 prej tyre, duke treguar hetim të Prokurorisë përtej fakteve dhe personave të kallëzuar nga KLSH-ja.

Në çështjet e dërguara për gjykim, prokuroria ka shqyrtuar detyrat e të pandehurve në bazë të parashikimeve të dispozitave ligjore administrative urdhëruese që kanë normuar veprimtarinë e tyre. Kërkesa për gjykim të secilës prej çështjeve përmban gjeneralitetet e të pandehurve, parashtrimin e fakteve në mënyrë të detajuar, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal dhe legjislacionit të fushës përkatëse, burimet e provës dhe faktet që ato u referohen, datën dhe nënshkrimin e prokurorit, por nuk përmban gjeneralitetet e të dëmtuarit nga vepra penale, përveçse dëmit financiar në rastet kur rezultojnë nga kallëzimi i KLSH-së, duke respektuar në përgjithësi kërkesat e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar 16 vendimeve të Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Tiranë ndaj kallëzimeve të KLSH-së gjatë vitit 2014, rezultojnë se në **1** çështje është vendosur mos fillimi i ndjekjes penale, **3** janë **dërguar për gjykim** dhe **12** janë **pushuar**.

Në 12 çështjet e pushuara, Prokuroria në Rrethin Gjyqësor Tiranë ka analizuar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit të kallëzuar nga KLSH-ja, dokumentacionin apo deklaratimet e administruara gjatë hetimit, në aspektin teknik dhe ligjor, **por jo në të gjitha rastet në aspektin financiar**. Hetimi i prokurorisë është fokusuar kryesisht në një analizë të thelluar të dokumentacionit të administruar, si dhe nga pohimet e marra nga personat në cilësinë e të pandehurit apo të dëshmitarit, duke ndjekur praktikë të ngjashme me hetimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për vepra penale të ngjashme.

Referuar vendimeve të Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Tiranë, rezultojnë se bazuar në Nenin 328 të K.Pr.P., respektivisht në pikat a), b) dhe d), çështjet janë pushuar për shkak se *fakti nuk ekziston, faktet e vërtetuara nuk përbëjnë veprë penale dhe për evidentimin e një shkakut ligjor që ka shuar veprën penale*. Nga hetimi i çështjeve të pushuara, Prokuroria ka nxjerrë konkluzionin se *nuk janë konsumuar elementët objektiv dhe subjektiv të veprave penale* të parashikuara nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal. Ndërsa në 3 prej vendimeve të pushimit ka rezultuar se janë evidentuar elementë të veprës penale bazuar veçanërisht në dokumentet e sekuestruara në cilësinë e provës materiale, por organi i akuzës ka konstatuar parashkrim të veprës penale, sipas nenit 66/c të Kodit Penal. Gjatë hetimit është konstatuar se ka kaluar afati ligjor, brenda të cilit mund të ushtrohet ndjekja penale, dhe në këto kushte Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes të kallëzuar nga KLSH-ja.

Për tre çështje, Prokuroria e Tiranës ka konstatuar konsumimin e elementëve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" apo "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të parashikuara nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal, duke argumentuar gjerësisht aspektin



teknik e ligjor të rrethanave. Kërkesat për gjykim përmbajnë gjeneralitetet e të pandehurve, parashtrimin e fakteve në mënyrë të detajuar, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal dhe legjislacionit respektivë, burimet e provës dhe faktet që ato u referohen, datën dhe nënshkrimin e prokurorit, por nuk evidentohen gjeneralitetet e të dëmtuarit nga vepra penale, përveçse dëmit financiar në rastet kur rezulton nga kallëzimi i KLSH-së, duke respektuar në përgjithësi kërkesat e nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, sikurse praktika e ndjekur nga Prokuroria në Rrethin Gjyqësor Durrës.

Në vendimin e vetëm për mos fillimin e ndjekjes penale, Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë ka konkluduar se fakti i paraqitur në kallëzim nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, në bazë të nenit 290/1/ç dhe 291/1 të K.Pr.P.

#### *b) Veprimet dhe afatet hetimore të Prokurorisë*

Referuar vendimeve të pushimit të procedimeve penale të Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Durrës, rezulton se hetimi ka zgjatur mesatarisht **8 muaj** që nga momenti i regjistrimit të procedimit. Ndërkohë, hetimi i 3 çështjeve penale për të cilat është kërkuar gjykim nga prokuroria ka zgjatur mesatarisht **15 muaj**, pra rreth 2 – fish i kohëzgjatjes së hetimit të çështjeve për të cilat është vendosur pushimi. Në total, hetimi i Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Durrës të kallëzimeve penale të KLSH-së gjatë vitit 2014 ka zgjatur mesatarisht **11.5 muaj**.

Në nenin 323, 324 dhe 325 të KPrP parashikohet afati 3-mujor i hetimeve, që nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale, zgjatjen e afatit të hetimit me tre muaj, por jo më shumë se 2 vjet në raste hetimesh komplekse dhe pamundësie objektive për t'i përfunduar brenda afatit, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj zgjatjes së afatit të hetimit nga i pandehuri apo i dëmtuari. Verifikimi ynë në këtë drejtim, për të dyja prokuroritë, ka qenë i pjesshëm dhe nuk kemi pasur akses në të gjithë dosjen e hetimit për të parë nëse afati i hetimeve është zgjatur me vendim të prokurorit apo jo.

Në 6 vendimet e Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Durrës konstatohet përgjithësisht një hetim i detajuar dhe i individualizuar, duke u fokusuar në rrethanat dhe faktet teknike, financiare dhe ligjore. Analiza e Prokurorisë është përqendruar kryesisht tek ballafaqimi i fakteve të provuara nga veprimet hetimore me parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhënien juridike, subjektet e së cilës rezultonin në procedim. Mesatarisht janë kryer rreth **20 veprime hetimore**, por në çështjet për të cilat është kërkuar gjykim nga Prokuroria konstatohet numër më i madh i veprimeve hetimore, konkretisht **deri në 37 veprime të tilla**, veçanërisht



pyetja e personave që kanë dijeni për ngjarjen dhe jo vetëm të personave të kallëzuar nga KLSH-ja, sikurse rezulton kryesisht në çështjet e pushuara nga Prokuroria.

Referuar vendimeve të Pushimit të procedimeve penale të Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Tiranë, hetimi ka zgjatur **nga 2 muaj deri në 9 muaj**, dhe **mesatarisht 5 muaj**, që nga momenti i regjistrimit të procedimit. Nga këto të dhëna rezultojnë afate më të shpejta hetimi, gati të përgjysmuara për hetimin e veprave penale të ngjashme, krahasuar me kohëzgjatjen e hetimit të Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Durrës.

Duke iu referuar praktikës së këtij organi që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit rezulton se, për çështje të kallëzuara nga KLSH-ja në përgjithësi kryhen të njëjtat veprime hetimore si: administrim dokumentacioni, pyetje e të kallëzuarve në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale dhe komunikim institucional nëpërmjet shkresave zyrtare për marrjen e të dhënave për hetimin e prokurorisë, si dhe në raste të pakta kryerje e aktit të ekspertimit për dëmet e mundshme financiare të shkaktuara. Analiza e prokurorisë është përqendruar kryesisht tek ballafaqimi i fakteve të provuara nga veprimet hetimore me parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike, subjektet e së cilës rezultonin në procedim. Mesatarisht janë kryer rreth **10 veprime hetimore**, por në çështjet për të cilat është kërkuar gjykim nga prokuroria konstatohet numër më i madh i veprimeve hetimore. Në disa raste mungon apo është i mangët hetimi në drejtimin financiar të fakteve të kallëzuara, duke ndjekur strukturën dhe tiparet e materialit kallëzues të KLSH-së, pa e tejkaluar atë.

#### *c. Zbatimi i masave të sigurimit gjatë hetimit të kallëzimeve të KLSH-së*

Lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal, parashikuar në nenet 227 e vijues të KPrP, konstatohet se në çështjet e pushuara personat e kallëzuar, të grup moshës 32 vjeç – 56 vjeç, janë hetuar pa masë sigurimi nga Prokuroria e Durrësit, ndërsa në dy nga tre çështjet e dërguara për gjykim nga kjo Prokurori, konkretisht në procedimin Penal Nr. 1223, datë 01.07.2014 dhe procedimin Penal Nr. 1785, të vitit 2014, personat e kallëzuar janë hetuar me masë sigurimi *“Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”*, bazuar në nenin 234 të KPrP.

Gjatë hetimit **nuk është mbajtur i njëjti standard për caktimin e masave të sigurimit për personat nën hetim**, në dy drejtime *së pari*, për çështje me objekt të njëjtë dhe për të njëjtat vepra penale të dyshuara se janë kryer nga shtetasit e kallëzuar nga KLSH-ja, masa e sigurimit *“Detyrim*

*për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" është caktuar vetëm në dy procedime penale që kanë rezultuar në kërkesa për gjykim dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar për hetime të cilat kanë rezultuar pushimin e çështjes penale; *së dyti*, brenda një procedimi penal, konkretisht Nr. 1785, të vitit 2014, 3 prej të akuzuarve janë hetuar nën masën e sigurimit "*Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", ndërsa një prej tyre pa masë sigurimi edhe pse pozita e tij zyrtare ishte më e lartë dhe roli i tij ishte më i rëndësishëm sa i takon mbikëqyrjes së procedurave të tenderimit.

Sa i takon Prokurorisë në Rrethin Gjyqësor Tiranë nuk rezultojnë të jenë marrë masa të sigurimit personal ndaj personave për të cilët kryhen hetime, ose ndaj të pandehurve, sikurse u konstatuan në disa vendime të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

*d) Pozita e zyrtarëve të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues në raport me vendimmarrjen e Prokurorisë*

Pozita e zyrtarëve të kallëzuar nga KLSH-ja është tregues i rëndësishëm i hetimit dhe ndëshkueshmërisë së veprave penale nga të cilat janë shkaktuar dëme financiare në buxhetin e shtetit gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve publike.

Bazuar në kategorizimin dhe klasifikimin e parashikuar në nenin 19 të Ligjit Nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, të kallëzuarit rezultojnë kryesisht zyrtarë ose ish zyrtarë të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese, si dhe nëpunës të tjerë ekzekutivë (specialistë dhe inspektorë) në sektorët të tillë si regjistrimi i pasurive të paluajtshme, koncesionet, prokurimet, ofrimin të shërbimeve publike si: ujësjellës, shërbimet portuale – doganore, legalizimeve, etj.

Specifikisht janë kallëzuar nga KLSH-ja dhe hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës: **1 ish zyrtar i kategorisë së lartë drejtuese; 6 zyrtarë të kategorisë së mesme drejtuese; 8 nëpunës zyrtarë të kategorisë së ulët drejtuese**, si dhe **7 punonjës të kategorisë ekzekutive**. Ndër ta, 16 persona janë të gjinisë mashkullore dhe 6 të gjinisë femërore.

Nga analiza e shifrave rezulton se **rreth 70 %** e zyrtarëve të kallëzuar nga KLSH-ja apo/dhe të hetuar nga Prokuroria në Rrethin Gjyqësor Durrës janë **punonjës ose zyrtarë të kategorisë ekzekutive dhe të ulët drejtuese**. Ndërkohë, rreth **27 %** të zyrtarëve i përkasin kategorisë së mesme drejtuese dhe vetëm **5 %** janë ish zyrtarë të kategorisë së lartë drejtuese.

Të kallëzuarit në Prokurorinë në Rrethin Gjyqësor Tiranë rezultojnë të jenë kryesisht nga radhët e zyrtarëve publikë, ose e ish zyrtarëve të kategorisë së mesme drejtuese, të ulët drejtuese dhe të kategorisë ekzekutive

(specialistë dhe inspektorë), dhe në raste të veçanta edhe të kategorisë së lartë drejtuese. Veçori e çështjeve të hetuara nga Prokuroria në Rrethin Gjyqësor Tiranë është fakti i përfshirjes në hetim të 20 shtetasve që nuk kanë ushtruar funksione apo detyra publike.

Nga analiza e shifrave rezulton, se **rreth 80 %** e zyrtarëve të kallëzuar nga KLSH-ja i përkasin **kategorisë ekzekutive dhe të ulët drejtuese**. Ndërkohë, rreth **10 %** e zyrtarëve i përkasin kategorisë së mesme drejtuese dhe kategorisë së lartë drejtuese.

Nga vendimet e prokurorisë ka rezultuar se vetëm ndaj 3 të kallëzuarve të KLSH-së është marrë vendimi për dërgimin e çështjes për gjykim. Të pandehurit nuk janë zyrtarë publik, por janë subjekte private që, sipas hetimeve të Prokurorisë kanë kryer vepra penale. Për zyrtarët publikë është vendosur mos fillim, ose pushim i çështjes penale.

Të dhënat statistikore mbi numrin e zyrtarëve të nivelit të lartë, të hetuar apo proceduar nga prokuroria në vijim të kallëzimeve të KLSH-së në Prokurorinë e Tiranës dhe të Durrësit, janë tregues i nivelit të ulët të ndëshkueshmërisë së këtyre zyrtarëve, për dëmet financiare të shkaktuara nga veprimtaria e paligjshme e tyre.

*e) Ankimi në rrugë administrative dhe gjyqësore i çështjeve të kallëzuara nga KLSH*

E drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor për vendimarrjen e organeve të administratës publike, përfshirë edhe vendimet e prokurorisë është një nga standardet e procesit të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e çdo individi e sanksionuar në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Njëkohësisht, ushtrimi i kësaj të drejte garanton kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë e organeve të administratës, përfshirë organet e pavarura audituese dhe të hetimit në procesin penal.

Në nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet e drejta e ankimit të *të dëmtuarit* dhe *të pandehurit* në gjykatë ndaj vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes. Në rastin e kallëzimeve penale të KLSH-së, në cilësinë e *të dëmtuarit* rezulton shteti, që në këto çështje “përfaqësohet” nga vetë KLSH-ja, veprimtaria e të cilit *synon përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij*.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Neni 2 i Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga studimi i 3 vendimeve të pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 12 vendimeve të pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj kallëzimeve të KLSH-së, ndër të tjera është vendosur edhe **njoftimi i të interesuarve për të ushtruar të drejtën e ankimit**, pa përcaktuar shprehimisht *“të interesuarit”* në vendim, duke ulur mundësinë e verifikimit të njoftimit faktik të të dëmtuarit (kallëzuesit) në këtë rast për vendimin e pushimit, me qëllim që të garantohet e drejta e ankimit. Nga informacionet e vëna në dispozicion nga Prokuroritë dhe Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Tiranë nuk rezulton të jetë bërë ankim në gjykatë ndaj vendimeve të pushimit, nga ana e KLSH-së. Në dallim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në 3 nga vendimet e pushimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur për të drejtën për ankim jo vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*siç u konstatua në çdo vendim*), por edhe te prokurori më i lartë, sipas nenit 24/5 të KPrP. Nga të dhënat e mbledhura nuk rezulton asnjë rast ankimi ndaj vendimit të pushimit tek prokurori më i lartë. Ndërsa në vendimin e mos fillimit të prokurorisë është përcaktuar KLSH-ja në cilësinë e kallëzuesit, si institucioni që duhet njoftuar dhe të drejtën e ankimit brenda 5 – ditëve nga njoftimi, në zbatim të nenit 291 të KPrP.

Në Kodin e Procedurave Administrative në fuqi dhe në legjislacionin administrativ në tërësi parashikohet e drejta e ankimit administrativ në organet e administratës publike, për adresimin e çështjeve. Ky institut është parashikuar edhe në Ligjin Nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, ku përcaktohet e drejta e këtij institucioni për të paraqitur ankim dhe adresim të gjetjeve të auditimeve të kryera në organet kompetente të administratës publike.

Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, konkretisht Vendimit nr.22, datë 07.20.2008 dhe Vendimit nr.37, datë 25.07.2013 rezulton se, përgjegjësia penale konkuron me përgjegjësinë administrative apo disiplinore. Në kushtet kur ka nisur një procedim penal, mund të ndiqet paralelisht edhe procedimi administrativ, në rast se është konstatuar një shkelje e tillë. Pra, nëse KLSH konstaton elemente të veprës penale dhe kallëzon subjektet përkatëse, paralelisht mund të rekomandojë që të merren masa administrative nga organet përkatëse të administratës publike.

Burimi i informacionit sa i takon rekomandimeve administrative të bëra nga KLSH për të njëjtat çështje për të cilat është paraqitur kallëzim penal është Buletini Nr. 4/2014 i KLSH-së. Në Formularin Nr.3 paraqiten evidencat e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre për vitin 2014. Ky informacion jepet në mënyrë të përmbledhur për të gjitha institucionet publike dhe jo në mënyrë të veçantë për çështjet e kallëzuara.

Nga të dhënat e pasqyruara në Formularin Nr.3 nuk del në pah në mënyrë të qartë dhe të detajuar se cilit prej kallëzimeve i përketin masat e marra administrative nga organet kompetente administrative. Për shkak të numrit të madh të rekomandimeve të KLSH-së për marrjen e masave administrative në raport me kallëzimet penale, rezulton se për disa çështje janë marrë vetëm masa disiplinore dhe administrative dhe nuk ka pasur kallëzim për ndjekje penale, por jo domosdoshmërisht rezulton se në çdo rast kur KLSH-ja ka kallëzuar penalisht, është rekomanduar njëkohësisht marrja e masave administrative.

Rezultojnë **1135 masa administrative të rekomanduara**, nga të cilat janë **zbatuar 732**, pra 64.5% e totalit, për vitin 2014. Ndër të tjera, në buletin pasqyrohen shumat e kërkuara për zhdëmtim financiar, ku për vitin 2014 KLSH-ja ka kërkuar **zhdëmtim në vlerën 11,085,084,000 Lekë**, për të cilën është **zbatuar zhdëmtimi në vlerën 3,737,734,000 Lekë**, pra në masën **34 % të totalit**, për vitin 2014. Këto informacione i përgjigjen të gjitha auditimeve të realizuara nga KLSH-ja për vitin 2014 dhe jo vetëm lidhur me rastet, për të cilat ka bërë kallëzim penal.

f) *Mungesa e informacionit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

Nga studimi i kallëzimeve të siguruara nga KLSH-ja, rezultojnë se për 7 (shtatë) prej tyre nuk është dhënë informacion apo kopje e vendimeve përkatëse nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga analiza e këtyre kallëzimeve rezultojnë 23 persona, të kallëzuar nga KLSH-ja për konsumimin e elementëve të veprave penale “*Mashtrimi*”, “*Falsifikimi i dokumenteve*”, “*Shpërdorimi i detyrës*”, apo “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, parashikuar respektivisht në nenet 143, 186, 248 dhe 258 të Kodit Penal.

Kallëzimet për të cilat KSHH nuk ka mundur të sigurojë vendimin e organit të Prokurorisë kanë në objekt mosrespektimin e kriterëve ligjore dhe nënligjore të lidhjes së kontratës, në kundërshtim me procedurat e prokurimit, përfitimin e pensioneve në mënyrë të padrejtë nëpërmjet falsifikimit, shkelje të kuadrit ligjor për legalizimet, shpërdorimi i lëndëve djegëse për furnizimin e makinave, etj.

Këto kallëzime i atribuohen zyrtarëve publik të kategorisë së mesme, të ulët drejtues dhe ekzekutive, si dhe shtetasve pa funksione apo detyra publike.

Nga këto 7 kallëzime, vetëm 4 prej tyre përmbajnë analizë dhe përshkrim të detajuar të dëmit ekonomik, aspektin teknik të rrethanave të faktit, si dhe elementin juridik, gjë që është reflektuar edhe tek Buletini nr.4/2014. Ndërsa, në 3 kallëzime të tjera të KLSH-së nuk është analizuar shkelja në ballafaqim me ligjin penal dhe është analizuar shkurtimisht dëmi i interesave shtetërore, por jo ekonomike. Në total, dëmi rezulton në vlerën **452,343 Lekë të reja**. **Studimi ynë lidhur me ecurinë** e hetimit të tyre është i pamundur objektivisht për shkak të mungesës së informacionit dhe vendimeve përkatëse të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 5. Praktika e denoncimeve të institucioneve të tjera të kontrollit

Me synim kryerjen e një analizë sa më të plotë dhe krahasuese, KShH-ja i është drejtuar institucioneve të tjera kontrolli, si Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) dhe ILDKPKI-së, për të përfituar informacionin e nevojshëm për rastet kur gjatë veprimtarisë së tyre kanë konstatuar shkelje disiplinore me fokus gjyqtarët apo kur kanë pasur dyshime për kryerjen e veprave penale të lidhura me korrupsionin apo të ngjashme me to.

Gjatë muajit Shkurt 2016, KShH i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë me kërkesë zyrtare për informim mbi kërkesat për procedim disiplinor të depozituara gjatë vitit 2014 në KLD, si dhe mbi kallëzimet penale ndaj gjyqtarëve për veprat penale të parashikuara në nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal. Ky institucion është përgjigjur<sup>9</sup> duke referuar 22 kërkesa për procedim disiplinor për 20 gjyqtarë, ndërsa për vendimarrjen e KLD-së, është shprehur se informacioni i saktë do të rezultonte nga ky institucion. Lidhur me kallëzimet penale ndaj rasteve të mundshme të korrupsionit nga ana e gjyqtarëve, **nuk rezulton që gjatë vitit 2014 Ministria e Drejtësisë të ketë paraqitur ndonjë kallëzim penal ndaj gjyqtarëve.** Në përgjigjen e vet ky institucion referon Prokurorinë e Përgjithshme, si organi kompetent që ushtron ndjekjen penale, pavarësisht se kërkesa e KShH-së lidhej drejtpërdrejtë me kallëzimet e mundshme të Ministrisë së Drejtësisë.

Më datë 12.02.2016, KShH i është drejtuar KLD-së nëpërmjet një shkresë zyrtare mbi rastet e procedimeve disiplinore dhe kallëzimeve penale ndaj gjyqtarëve, gjatë vitit 2014. KLD-ja është përgjigjur zyrtarisht<sup>10</sup>, ku ka informuar mbi 22 kërkesa për procedim disiplinor të paraqitura pranë KLD-së për 20 gjyqtarë të cilët kanë rezultuar me masa disiplinore si: “Vërejte”, “Vërejtje me paralajmërim”, “Transferim” apo “Shkarkim”. KLD-ja ka informuar rreth shkarkimit të dy gjyqtarëve për shkak të nisjes së procedimit penal ndaj tyre dhe gjykimin për veprën penale të korrupsionit pasiv, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Në korrespondencën e KLD-së, nuk ka informacion të mjaftueshëm mbi subjektin që ka vënë në lëvizje organin e prokurorisë, nëse procedimi ka filluar kryesisht apo mbi bazën e një kallëzimi.

9 Shkresë nr. 1288/1 Prot, dt.23.02.2016 të Ministrisë së Drejtësisë

10 Shkresë nr. 797/1 Prot, dt.23.02.2016 të KLD-së



Gjithashtu, më datë 12.02.2016 KShH i është drejtuar ILDKPKI-së nëpërmjet shkresës zyrtare duke kërkuar informacion mbi kallëzimet penale të këtij institucioni në Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës gjatë vitit 2014, si dhe mbi ecurinë e hetimit të tyre lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion. ILDKPKI është përgjigjur nëpërmjet adresës elektronike duke informuar se, gjatë vitit 2014 ka depozituar 74 kallëzime, nga të cilat 20 në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Nga informacioni i marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton se për çdo kallëzim të ILDKPKI-së është marrë vendim pushimi dhe nuk është konstatuar asnjë rast ankimi në gjykatë ndaj tyre, sipas KPrP. Kjo e dhënë rezulton edhe nga Raporti Vjetor i këtij institucioni pasi informacioni mbi shkeljet e ligjit, pasuritë në vlera të larta të fshehura apo të padeklaruara nga zyrtarët e lartë publikë, si dhe kallëzimet penale është i hollësishëm, ndërsa mungon informacioni në lidhje me ecurinë e këtyre kallëzimeve dhe ankimet e mundshme të këtij institucioni në rast pushimi apo mos fillimi të procedimit penal.

Këto të dhëna reflektojnë qëndrim dhe qasje të njëjtë institucionale të institucioneve të kontrollit ose atyre të pavarura me atë të KLSH-së ndaj vendimmarrjes së prokurorisë, në lidhje me kallëzimet e tyre. Pavarësisht dëmeve në shuma të konsiderueshme financiare, mundësia për të ushtruar kontrollin gjyqësor ose kontrollin nga prokurori më i lartë është “pakësuar” edhe për shkak të mungesës së ankimeve ndaj vendimeve të mos fillimit apo pushimit të prokurorisë, bazuar në nenet 291/2 dhe 329/1 të KPrP.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson se, interesat e shtetit dhe të shoqërisë mund të dëmtohen rëndë, nëse nëpunësit publikë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre apo për shkak të funksionit kufizohen vetëm në kallëzimet penale dhe nuk ndjekin ecurinë e tyre, veçanërisht kur prokurori vendos mos fillimin e procedimit penal dhe pushimin e çështjes.

Në legjislacionin procedural-penal dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (Vendimi nr.26, dt.04.12.2006) është parashikuar e drejta e kallëzuesit apo ankuesit për ankim ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal, ndërsa në nenin 329/1 të K.Pr.P. është parashikuar mundësia e ankimit në gjykatë nga *i dëmtuari* dhe i pandehuri ndaj vendimit të Prokurorisë për rrëzimin e akuzës apo pushimin e çështjes përkatëse.

Në rastin e kallëzimeve të institucioneve publike të pavarura, si KLSH-ja apo ILDKPKI-ja, roli procedural i *të dëmtuarit* i përket këtyre institucioneve, për shkak se kallëzimet adresohen gjatë veprimtarisë dhe për shkak

të funksionit shtetëror që ato kryejnë. Veprat penale për të cilat këto institucione adresojnë kallëzime penale në prokurori, të parashikuara nga nenet 248, 257, 258, etj., janë kryesisht **vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore**, duke vepruar në emër dhe për llogari të “shtetit”, ose “të të dëmtuarit”.

Këtë qëndrim KShH ia ka adresuar zyrtarisht Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.<sup>11</sup> Në Projekt-Rezolutën “Për vlerësimin e punës së ILDKPKI-së për vitin 2015”, ky Komision ka reflektuar objeksionet e KShH-së, duke kërkuar që ILDKPKI-ja të ketë në fokus të punës gjatë vitit 2016 “...ushtrimin e të drejtës për ankimim bazuar në KPrP lidhur me vendimet e mos fillimit të procedimit penal dhe pushimit të çështjes nga organi i akuzës”.

---

11 Shkresë nr.278 Prot, dt.03.05.2016 e KShH

## 6. Gjetjet e rezultuara nga monitorimi i seancave gjyqësore për çështjet e korrupsionit të gjykuara në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit Tiranë dhe Durrës, si dhe në Gjykatën e Krimeve të Rënda

### 6.1 Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur

Një nga tre objektivat specifike të nismës së KShH-së në kuadër të këtij raporti studimor lidhet me përmirësimin e transparencës dhe zbatimin e parimeve të procesit të rregullt gjyqësor, në proceset gjyqësore për çështjet penale të korrupsionit.

**Objekt** i monitorimit ishin seancat gjyqësore për gjykimin e veprave penale të korrupsionit në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës, në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe gjykatat respektive të apelit, duke u fokusuar më nënryrë të veçantë tek respektimi i standardeve të procesit të rregullt gjyqësor, si parimi i solemnitetit, paanshmëria e gjyqtarit/trupit gjykues, publiciteti i seancës gjyqësore, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, prania e palëve në proces, parimi i barazisë së armëve juridike, etj.

Stafi i KShH-së përgatiti një metodologji për monitorimin e këtyre proceseve dhe hartoi modelin e pyetësorit, duke u bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe standardet e një gjykimi të rregullt, duke u bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

KShH përzgjedhi nga rrjeti i gjerë i vëzhguesve, **11 persona për monitorimin** e seancave gjyqësore për çështje të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, apo çështje të tjera të ngjashme. Monitoruesit u përzgjedhën duke marrë në konsideratë përvojën dhe aftësitë e tyre profesionale në misionet e mëparshme të monitorimit të KShH-së. Vëzhguesit u trajnuan me synim rritjen e kapaciteteve të tyre sa i takon monitorimeve tematike të seancave gjyqësore për veprat penale në fushën e korrupsionit, metodologjinë e monitorimit dhe të raportimit.

Për një periudhë 6 mujore, Shkurt – Korrik 2016, vëzhguesit monitoruan **53 seanca gjyqësore**, përkatësisht në Gjykatat e Shkallës së Parë në Tiranë dhe Durrës, Gjykata e Apelit në Tiranë dhe Durrës, si dhe Gjykatën e Shkallës

së Parë të Krimeve të Rënda. Monitorimi i seancave gjyqësore u fokusua kryesisht në çështjet për **veprat penale të parashikuara në nenet 244, 245, 259, 260, 319 dhe 319 / ç të Kodit Penal**, të cilat lidhen me korrupsionin, por në disa çështje përfshiheshin edhe veprat penale të tjera penale të ndërlidhura, të parashikuara në nenin 172, 175, 186/3, 248, 291 dhe 301 të Kodit Penal<sup>12</sup>. Në total, **numri i të pandehurve** në proces gjykimi në çështjet e monitoruara rezultoi në **31 persona**, me shtetësi shqiptare, me përjashtim të **1 të huaji me shtetësi kineze**.

Parimet të cilat udhëhoqën vëzhguesit në këtë monitorim ishin respektimi i rregullave të etikës, rregullave të sigurisë dhe kontrollit në gjykatat përkatëse si dhe oraret e seancave, mospërdorimi i telefonit celular apo pajisjeve të tjera të ndaluara në sallën e gjykit, parimet e profesionalizmit, paanshmërisë dhe objektivitetit.

Rastet të cilat janë monitoruar janë përzgjedhur nga stafi i projektit. Kalendari i seancave të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë ka qenë publik në faqen zyrtare, prej të cilave janë përzgjedhur seancat gjyqësore të monitoruara. Informacioni mbi seancat gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Apelit Durrës është siguruar nga takimet e drejtpërdrejta apo shkresave të dërguara nga kryetarët apo kancelarët e këtyre gjykatave. Kriteri parësor i përzgjedhjes së seancave gjyqësore të monitoruara ka qenë çështjet penale, për ato nene të Kodit Penal që parashikojnë veprat penale në fushën e korrupsionit dhe që janë objekt i këtij raporti studimor.

Pas procesit të monitorimit, vëzhguesit kanë hartuar një *raport* për çdo seancë gjyqësore me gjetjet kryesore dhe në përfundim kanë plotësuar një pyetësor të detajuar me të dhënat e nevojshme për mbarëvajtjen e gjykit.

## 6.2 Gjetjet lidhur me aspektet e procesit të rregullt gjyqësor dhe mbarëvajtjen në gjykatë

### a) Orari i fillimit të seancave

Nga 53 seanca gjyqësore të monitoruara, **11 seanca kanë filluar** në kohën e paracaktuar, **41 kanë filluar me vonesë** ose **rreth 77 % e totalit**, ndërsa për 1 seancë gjyqësore nuk ka të dhëna mbi respektimin e orarit të çeljes

<sup>12</sup> Respektivisht: Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë - neni 172, Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore - neni 175 K.P, Falsifikimi i dokumenteve - neni 186/3 K.P., Shpërdorim detyre - neni 248, Drejtim mjete në mënyrë të parregullt - neni 291 K.P., Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës - neni 301

së saj. Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda ka respektuar më shumë orarin e çeljes së seancave gjyqësore të monitoruara në raport me gjykatat e tjera.

Shkaqet e fillimit të çështjeve me vonesë kanë qenë të lidhura me mbivendosjen e orareve të gjykimit të anëtarëve të trupës gjyqësore, të prokurorit të çështjes, vonesat e avokatëve mbrojtës apo mosparaqitja e të pandehurve. Në disa raste këto vonesa janë shkaktuar për shkaqe të organizimit të brendshëm të gjykatës si sistemimi i pjesëmarrësve në sallë apo për shkak të vonesës së ekspertëve të thirrur në proces.

Nga seancat që kanë filluar me vonesë, trupa gjyqësore ka relatuar shkaqet e vonesës vetëm në **6 raste**, ndërsa nuk janë relatuar shkaqet nga gjykata në **35 seanca** të filluara me vonesë, duke përbërë rreth **85 %** të totalit të tyre.

Kohëzgjatja mesatare e vonesave për fillimin e seancave gjyqësore është rreth **10 minuta**. Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezultoi një mesatare pak më e lartë e kohëzgjatjes së vonesave në krahasim me gjykatat e tjera, në rreth 12 minuta.

#### *b) Vendi i zhvillimit të seancave gjyqësore*

Me qëllim rritjen e solemnitetit dhe publicitetit, zhvillimi i seancave gjyqësore duhet të realizohet në ambiente të përshtatshme për subjektet pjesëmarrëse në gjykim dhe publikun, konkretisht në sallat e gjykimit.

Monitorimi evidentoi se 87% seancave gjyqësore të monitoruara janë zhvilluar në sallat e gjykimit, ndërsa në **13% të rasteve**, seancat gjyqësore janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve. Seancat gjyqësore të zhvilluara në zyrat e gjyqtarëve i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, në çdo rast, seancat janë zhvilluar në sallat përkatëse të gjykimit.

Gjithashtu, në një rast, në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, gjykimi është zhvendosur nga zyra e gjyqtarit në sallë, për shkak të pamundësisë së sistemimit të të pranishmëve. Në një rast tjetër në të njëjtën gjykatë, zyra e gjyqtarit me një sipërfaqe prej 12m<sup>2</sup> ka qenë e papërshtatshme për zhvillimin e gjykimit, pasi trupi gjykues prej tre gjyqtarësh ishte i ndarë në dy tryeza, avokati mbrojtës ishte i ulur ngjitur me përfaqësuesen e prokurorisë, ndërsa i pandehuri i akuzuar për kryerjen e *korruptionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike* qëndronte në këmbë së bashku me vëzhguesit e KShH-së.

Në të gjitha rastet kur seanca gjyqësore është zhvilluar në zyrën e gjyqtarëve, të pandehurit kanë qenë pa masë sigurimi personal. Në 3 nga këto seanca, gjykata është shprehur se shkak i zhvillimit të gjyqimit në ambientet e zyrës lidhet me sallat e zëna nga procese të tjera gjyqësore, ndërsa 1 rast tjetër për shkak se gjykata ishte njoftuar paraprakisht për mungesën e përfaqësuesit të prokurorisë dhe nuk kishte vlerësuar të nevojshme zhvillimin formal të seancës në sallë, pasi do të shtyhej për një datë tjetër.

### c) *Publiciteti i seancave gjyqësore*

Publiciteti i seancës gjyqësore ka një rëndësi thelbësore për procesin e rregullt ligjor, të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe nenin 339 të Kodit të Procedurës Penale. Cënimi i publicitetit të seancës gjyqësore, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në nenin 340 të këtij kodi, passjellë **pavlefshmërinë e seancës**.

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore ka rezultuar se në shumicën e rasteve, vëzhguesve të KShH-së nuk i janë shfaqur pengesa nga punonjësit e sigurisë apo punonjës të tjerë në gjykatë. Në rreth **90 % (48 seanca)** të rasteve nuk ka pasur pengesa në monitorim, ndërsa vetëm në **3 raste**, pavarësisht se monitoruesit e KShH-së janë lejuar të vëzhgojnë, ata kanë hasur paraprakisht në vështirësi, veçanërisht në hyrje të gjykatës. Konkretisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, vëzhguesit e KShH-së janë pyetur nga punonjës sigurie për arsyen e hyrjes në godinë. Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda<sup>13</sup>, vëzhguesit i janë nënshtruar kontrolleve të imtësishme fizike në hyrje dhe është përcaktuar vendqëndrimi, pavarësisht se në sallë ka pasur vende të lira mjaftueshëm për të ndjekur zhvillimin e seancës gjyqësore.

Nuk është konstatuar asnjë rast ku përfaqësuesit e KShH-së të jenë penguar nga trupa gjyqësore në monitorimin e seancave gjyqësore, ndërkohë që veprimet, kontrollet fizike dhe përcaktimi i vendit konkret për t'u ulur nga punonjësit e sigurisë vlerësojmë se pengojnë aksesin efektiv të publikut në monitorimin e seancave gjyqësore. Gjykatat e monitoruara nuk kanë marrë asnjë vendim të ndërmjetëm për gjykim me dyer të mbyllura, pasi nuk kanë qenë kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale për marrjen e këtij vendimi.

Në disa raste të monitoruara, për çështje që kanë pasur ndjeshmëri publike ose vëmendjen e medias, gjykata ka lejuar vetëm në fillim të seancës

<sup>13</sup> Si p.sh. në të gjitha seancat e çështjes me të pandehur ish – prokuror e të tjerë, për veprat penale të parashikuara në nenin 319 dhe 319/ç të Kodit Penal (*Korrupsion aktiv dhe pasiv i gjyqtarit, prokurorit dh funksionarëve të tjerë të drejtësisë*).

praninë e kamerave televizive, ndërsa gazetarët janë lejuar pa pengesa për monitorimin e vijueshmërisë së seancës. Në të gjitha seancat e realizuara në sallë, procesi gjyqësor është regjistruar me sistemin elektronik të regjistrimit audio, duke ndikuar pozitivisht në respektimin e parimit të transparencës dhe aksesit.

Aksesi në informacion mbi të dhënat dhe ecurinë e proceseve gjyqësore nga publiku përbën aspekt të rëndësishëm në funksion të publicitetit të seancave gjyqësore dhe transparencës ndaj shtetasve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Krimeve të Rënda punojnë me sistemin ART-it, një sistem elektronik i menaxhimit të çështjeve, i cili mundëson edhe aksesin on-line nëpërmjet faqeve të këtyre gjykatave lidhur me të pandehurit, objektin e çështjeve, ecurinë, kohëzgjatjen, si dhe të dhënat për seancën e ardhshme të çështjeve penale në proces. Ndërsa gjykatat e tjera përdorin sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS, i cili është i lidhur me një portal online, të menaxhuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili për disa nga këto gjykata mundëson shfaqjen e listës së çështjeve në gjykim por nuk mundëson informacion për ecurinë dhe kohëzgjatjen. Mungesa e infrastrukturës elektronike e portalit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk na mundësoi të kishim një informacion më të plotë sikurse në dy gjykatat e tjera, pavarësisht vullnetit dhe bashkëpunimit shumë të mirë me kryetaren dhe administratën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

#### *d) Respektimi i solemnitetit dhe etikës në proceset gjyqësore*

Solemniteti në gjykim, konsiston në zhvillimin e procesit gjyqësor në respektim të disa standardeve si: vendi i posaçëm<sup>14</sup> dhe kushtet e zhvillimit të gjykimit, veshja e posaçme, dhe sjellja e përshtatshme e subjekteve të pranishëm<sup>15</sup>, ndërsa etika nënkupton pjesëmarrjen e gjyqtarëve në përcaktimin, respektimin dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes si dhe ruajtja e një pozicioni që bën të mundur pavarësinë, paanësinë dhe drejtësinë e tyre si gjyqtarë<sup>16</sup>.

Në seancat gjyqësore të monitoruara, KShH-ja ka konstatuar se në 72% të tyre, përkatësisht në **38 raste**, trupi gjyqësor ka mbajtur veshjen e posaçme. Në Gjykatën e Krimeve të Rënda është respektuar gjithmonë mbajtja e veshjes së posaçme nga trupi gjykses.

14 Shih në pikën 3.2

15 Referuar Vendimit Nr. 232/8, datë 07.07.2008 dhe Vendimit Nr.238/1/b, datë 24.12.2008 "Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit" të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

16 Kodi i Etikës Gjyqësore, të Konferencës Gjyqësore Kombëtare.



Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se në **4 raste ose 7.5% të çështjeve të monitoruara, përfaqësuesi i prokurorisë nuk ka mbajtur veshjen e posaçme**. Nga këto raste, vetëm një i përket gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.

Mbajtja e veshjes së posaçme gjatë gjykimit nga **avokatët mbrojtës, të zgjedhur apo të caktuar kryesisht, është respektuar në të gjitha seancat e monitoruara**.

Subjektet e procedimit penal, duke përfshirë edhe trupin gjykues kanë respektuar në përgjithësi etikën e komunikimit, veçanërisht në seancat gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Konkretisht, në **49 raste** është respektuar etika e komunikimit nga pjesëmarrësit në gjykimin penal dhe në **4 raste** të tjera etika e komunikimit nuk është respektuar, por kjo nuk është reflektuar në njëanshmëri të gjyqtarëve gjatë seancës.

Vlen të theksohet se, në 1 seancë gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda (*para fillimit të saj*), kryesuesi i trupit gjyqësor ka reaguar ashpër dhe në konfidencë ndaj avokatit mbrojtës për shkak të vonesës dhe mënyrës së komunikimit të tij në telefon, duke nënkuptuar komunikim jashtëgjyqësor ndërmjet tyre. Në dy raste të tjera të monitoruara në të njëjtën gjykatë, para fillimit të seancës gjyqësore, në korridorin e gjykatës është konstatuar një komunikim jo mjaftueshëm etik nga ana e punonjësve të sigurisë.

#### e) *Mbrojtja me avokat*

Në nenin 48 dhe 49 të K.Pr.P parashikohet e drejta e të pandehurit për të pasur avokat të zgjedhur apo të caktuar kryesisht, si një nga të drejtat themelore procedurale, garanci për zhvillimin e një procesi objektiv, të drejtë dhe efektiv gjyqësor.

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se nga 31 të pandehur në total, **97 %** e tyre janë gjykuar **me mbrojtës të zgjedhur** nga vetë ata. Në 1 rast i pandehuri është përfaqësuar në gjykim nga një avokat mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata, i cili është zëvendësuar gjatë procesit nga një avokat tjetër mbrojtës i zgjedhur privatisht me deklaram nga i pandehuri para trupit gjykues.

Gjatë ecurisë së proceseve gjyqësore të monitoruara është vërejtur se për 6 të pandehur është zëvendësuar mbrojtësi i zgjedhur nga vetë ata me mbrojtës të caktuar kryesisht nga gjykata, veçanërisht ajo e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, për shkak mungesës së vazhdueshme të avokatëve privat në disa seanca. Në përgjithësi, të pandehurit kanë kërkuar vazhdimin e mbrojtjes

nga avokatët e caktuar prej tyre, por për shkak të ekonomisë gjyqësore dhe efektivitetit janë caktuar avokatë kryesisht nga gjykata, në zbatim të nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale. Në seancat pasardhëse, të pandehurit kanë kërkuar të mbrohen sërish nga avokatët e zgjedhur prej tyre, për të cilat gjykata ka vendosur pushimin e funksioneve të avokatëve të caktuar kryesisht, si dhe zëvendësimin e tyre. Rrjedhimisht, pavarësisht nga masat e marra nga trupi gjykues për të mos zvarritur procesin gjyqësor, zëvendësimi i avokatëve nuk ka rezultuar efektiv. Kjo mund të kërkojë një rishikim të kujdesshëm të Kodit të Procedurës Penale, për të gjetur një formulë efektive që garanton proporcionalitet midis të drejtës për një proces të rregullt dhe të drejtës për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm që ka në thelb gjykimin e pandërprerë. Në përgjithësi mbrojtja dhe përfaqësimi ligjor nga mbrojtësit e zgjedhur privatisht ka qenë profesionale.

#### f) *Paanshmëria dhe barazia e armëve juridike*

Barazia e armëve juridike gjatë procesit gjyqësor përbën një nga garancitë thelbësore të procesit të rregullt, si dhe nënkupton në parim mundësinë që palët në gjykimin penal të kenë njohuri dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura për të influencuar në vendimin e gjykatave. Parimi i barazisë së armëve kërkon “një balancë të drejtë ndërmjet palëve”, ku secilës palë duhet t’i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh të konsiderueshëm vis-à-vis kundërshtarit të saj<sup>17</sup>.

Nga monitorimi i mënyrës se si janë paraqitur kërkesat për marrjen e provës dhe vendimmarrja e trupit gjykues për këto prova dhe mënyrës së administrimit të tyre në seancë gjyqësore, është vërejtur se në tërësi është zbatuar parimi i barazisë së armëve juridike nga gjykatat e monitoruara. Normat e KPrP - së që parashikojnë mënyrën e gjykimit dhe marrjes së provave janë respektuar, pavarësisht të pandehurve, veprës penale për të cilën gjykohen, apo gjykatës ku zhvillohet procesi.

Nga monitorimet e zhvilluara nuk ka rezultuar që një trup gjykues të ketë shfaqur njëanshmëri për ndonjë nga palët në proces gjykimor apo të ketë evidentuar shfaqje të dukshme të kompromiseve midis të tre subjekteve të procedimit penal, gjykatës, prokurorisë dhe të pandehurit.

Edhe pse në përgjithësi, konstatimi është pozitiv në këtë drejtim, në disa raste të veçanta, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Krimeve të Rënda, para fillimit të procesit gjyqësor, apo gjatë pritjes në raste ndërprerje, avokatët mbrojtës, si dhe përfaqësues të prokurorisë kanë

17 Shih Batsanina k. Rusicë, nr. 3932/02, § 22, 26 maj 2009, Lika dhe Laska k. Shqipërisë, dt. 20 Prill 2010.

zhvilluar biseda miqësore ndërmjet tyre apo me anëtarë të trupit gjykues, duke “kompromentuar” objektivitetin dhe paanshmërinë e gjykimit. **Kjo dukuri nuk është manifestuar gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore.** Pavarësisht nga kjo e fundit, raste të tilla mund të rrisin mosbesimin e publikut në organet e drejtësisë dhe mund të evitohen.

*g) Zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm*

Në Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale dhe në akte ndërkombëtare nuk është përcaktuar një afat maksimal për kohëzgjatjen e gjykimit, por në secilën prej tyre është përcaktuar kohëzgjatja si një nga komponentët kryesorë të procesit të rregullt gjyqësor, si një e drejtë themelore e njeriut.

Zvarritja e proceseve gjyqësore është evidentuar si një çështje shqetësuese në sistemin tonë të drejtësisë, çka sjell mungesë besimi të theksuar nga ana e publikut në dhënien e drejtësisë dhe ndikon gjithashtu në perceptimin e nivelit të pandëshkueshmërisë.

Gjatë periudhës së monitorimit, nga historiku i seancave gjyqësore ka rezultuar se **kohëzgjatja mesatare e gjykimit** ka qenë rreth **138 ditë**, ku më e larta është konstatuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda me **kohëzgjatje mesatare prej 169 - ditësh**, për çështje të gjykuara për të njëjtat vepra penale.

Periodiciteti i shtyrjes së seancave gjyqësore të monitoruara rezulton **mesatarisht me 9.5 ditë**, me një diferencë pothuajse të pandjeshme ndërmjet gjykatave të ndryshme të monitoruara. Në përgjithësi, kohëzgjatja e shtyrjes së seancave nuk ka qenë më shumë se 2 javë, me përjashtim të **3 rasteve**, ndër të cilat **2** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, ku sipas kalendarit të çështjes rezulton se shtyrja ka qenë deri në **41 ditë**, për shkak edhe të lejeve vjetore të detyruara. Konkretisht në një çështje penale të zhvilluar nga kjo gjykatë, seanca e datës 28.07.2016 është shtyrë për shkak të mungesës së avokatëve të të pandehurit për në datën 07.09.2016.

Nga të dhënat e kalendarit të çështjeve në faqen zyrtare të gjykatave dhe monitorimit të seancave gjyqësore kanë rezultuar një sërë shkaqesh në shtyrjen e seancave gjyqësore për veprat penale të korrupsionit.

Konkretisht, është konstatuar shkak i ndërprerjes dhe shtyrjes së seancave gjyqësore është:

- i. Në 50.6% të rasteve, për shkaqe të lidhura me mungesën e të pandehurit, mbrojtjesit të tij/saj ose për shkak të paraqitjes së

- kërkesave nga mbrojtësit për t'u njohur me aktet e çështjes apo për të paraqitur konkluzionet përfundimtare.
- ii. Në 10% të rasteve, për shkak të paraqitjes së kërkesave të tjera për marrjen e provave;
  - iii. Në 10% të rasteve, për shkak të mbarimit të orarit zyrtar të gjykatës, mungesës së ekspertëve, përkthyesve;
  - iv. Në 8% të rasteve, për shkaqe të lidhura me njoftimin e dëshmitarëve;
  - v. Në 4% të rasteve, për shkaqe të lidhura me mungesën e prokurorëve;
  - vi. Rreth 17.4% për rrethana të tjera që nuk mund të kategorizohen në shkaqet e mësipërme.

### **6.3 Gjetjet lidhur me aspektet tematike të lidhura me gjykimin e të pandehurve të akuzuar për veprat penale në fushën e korrupsionit**

#### **a) Të dhëna për statusin e të pandehurve dhe gjeneralitetet e tyre**

Në monitorimet e realizuara nga KShH ka rezultuar se nga 31 të pandehur, ndaj 5 prej tyre është marrë masa sigurisë “Arrest në burg”, ndaj 6 të pandehurve është marrë masa e sigurisë “Arrest në shtëpi”, 14 të pandehur janë gjykuar në gjendje të lirë, ndërsa për 6 të pandehurit e tjerë nuk rezulton informacion lidhur me masën e sigurimit. Për 50 % e të pandehurve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda është caktuar masa e “arrestit në burg”, ndërsa në gjykatat e tjera të paktën 56 % e të pandehurve janë gjykuar në gjendje të lirë, duke reflektuar në mënyrë proporcionale rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale për të cilat akuzoheshin këta të pandehur.

Veprat penale për të cilat akuzoheshin të pandehurit e gjykuar janë si vijon:

- i. *Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike* – 6 të pandehur,
  - ii. *Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike* – 11 të pandehur,
  - iii. *Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë* – 4 të pandehur,
  - iv. *Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë* – 4 të pandehur,
  - v. *Shpërdorim detyre* – 3 të pandehur,
  - vi. *Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike* – 1 i pandehur,
  - vii. *Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore* – 2 të pandehur,
- Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës* – 1 i pandehur,

- viii. Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë – 2 të pandehur,
- ix. Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt – 1 i pandehur,
- x. Falsifikimi i dokumenteve – 1 i pandehur

Ndër veprat penale të sipërpërmendura, në 8 procese gjyqësore kanë rezultuar **bashkë të pandehur**.

Rreth 80 % e të pandehurve rezultojnë shtetas të punësuar në **sektorin publik** dhe 20 % në **sektorin privat, ose të papunë**. Referuar kategorizimit të parashikuar në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pandehurit të punësuar në sektorin publik i përkasin pothuajse në 100 % të rasteve nivelit të ulët drejtues dhe ekzekutiv (specialistë). Këta të pandehur rezultojnë të punësuar ose ish të punësuar në sektorin publik i përkasin fushave të ndryshme të shërbimeve publike, si në shërbimet doganore, policisë rrugore, shërbimit mjedisor, energjetikë, drejtësi, etj. Tre të pandehur janë në radhët e sistemit të drejtësisë, konkretisht 1 gjyqtar dhe 2 prokuror.

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore është vërejtur se ndaj të pandehurve të punësuar në sektorin publik, organet e administratës publike, duke përfshirë edhe organet e drejtësisë kanë vendosur pezullimin e ushtrimit të funksionit deri në përfundim të gjykimit përkatës. Në raste të pakta nuk janë ndërmarrë masa administrative, paralelisht me procesin penal.

Në disa raste, gjatë monitorimit të seancave gjyqësore nuk ka rezultuar informacion lidhur me kallëzuesin ose mënyrën se si ka filluar procedimi penal. Në rastet e tjera vërehet se, kallëzimi është bërë nga shtetas pa funksione publike, të cilët më së shumti janë persona të dëmtuar nga procesi penal. Vlen të theksohet shembulli pozitiv i fillimit të hetimeve, me anë të kallëzimit penal të një shtetasi, nga një prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprën penale “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë”.

Edhe gjatë periudhës së monitorimit të seancave gjyqësore, vërehet se mungojnë rastet e gjykimit të të pandehurve, zyrtarë të lartë të nivelit drejtues ose funksionarë të lartë të shtetit. Ky konstatim është i njëjtë me atë që rezulton nga studimi i vendimeve gjyqësore, pavarësisht shtrirjes së ndryshme kohore (*Studimi gjatë viteve 2013-2014 dhe Monitorimi, Shkurt - Shtator 2016*).

Në numër relativisht të ulët ka qenë fillimi i hetimeve bazuar në pamjet filmike të publikuara në emisionet investigative në televizion apo hetimi kryesisht.

**b) Të dhëna për gjykimin e të pandehurve**

Në nenin 403 e vijues të K.Pr.P. është parashikuar instituti juridik i *gjykimit të shkurtuar*. Gjykimi i shkurtuar ka si synim shmangien e një procedure të zakonshme për efekt të ekonomisë gjyqësore, por ai nuk duhet të dëmtojë në vetvete dhënien e një vendimi të drejtë. Në këtë kontekst, të drejtën për të vendosur në lidhje me gjykimin e posaçëm e ka gjykata, e cila duhet t'i bëjë një vlerësim paraprak akteve.

Në raporte të ndryshme studimore, KShH ka ngritur shqetësimin e mundësisë së abuzimit me këtë institut juridik nga të pandehurit, në rastet e veprave penale veçanërisht të rënda dhe/ose kur të pandehur janë zyrtarë apo ish zyrtarë publikë, pavarësisht plotësimit apo jo të kushteve për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe mundësisë së vendimmarrjes së drejtë në gjendjen që ndodhen aktet e marra gjatë hetimit.

Në proceset gjyqësore në fokus të monitorimit ka rezultuar se, në 6 raste është aplikuar gjykimi i shkurtuar, në vijim të kërkesës së paraqitur nga të pandehurit. Në një rast, çështja në gjykim është ndarë për një pandehur për shkak se nuk ka kërkuar gjykim të shkurtuar, sikurse bashkë të pandehurit e tjerë.

Vetëm **3 të pandehur** kanë pranuar akuzën e ngritur nga prokuroria para gjykatës, ndërkohë që në Gjykatën për Krime të Rënda nuk ka pasur raste të tilla.

Në kërkesat për gjykim të Prokurorisë dhe në konkluzionet përfundimtare ka rezultuar, se veprimet korruptive të të pandehurve kanë pasur objekt material *paratë*, të huaja apo shqiptare, që arrijnë vlera relativisht të larta, deri rreth 30,000 Euro. Me anë të këtyre shifrave është synuar të ndikohet në vendimmarrjen e zyrtarëve të administratës publike duke përfshirë prokurorë dhe gjyqtar, në favor të interesave të personave privat.

Rreth 50 % e çështjeve të monitoruara deri në fund të muajit Korrik të këtij viti, kanë rezultuar me vendime gjyqësore. Shpallja e vendimit gjyqësor është bërë verbalisht nga trupi gjykues duke bërë një arsyetim të përmbledhur. Në asnjë çështje, nuk është shpallur vendimi i plotë i arsyetuar.

Ndër vendimet gjyqësore të shpallura gjatë monitorimit të KShH-së, dënimet që janë zbatuar më së shumti nga gjykata në rast fajësie kanë qenë dënimi me burg.

Gjatë monitorimit është konstatuar ndjekja e politikës së ngjashme penale nga Prokuroria dhe Gjykata, veçanërisht ato për Krimet e Rënda. Masat e dënimit me burgim kanë rezultuar në kufijtë e minimumit ose mesatares së parashikuar nga Kodi Penal, maksimalisht deri në 3.5 vite burgim. Në çështjet që kanë rezultuar me vendim fajësie, është zbatuar gjykimi i shkurtuar, i cili, në disa raste ka ulur masën e dënimit nën minimumin e parashikuar në ligj për veprën penale konkrete. Prokuroria dhe gjykata kanë ndjekur politikë penale proporcionale në raport me rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurve, në kuptimin e dallimit të subjekteve, të posaçme apo të përgjithshme, me funksione publike dhe shtetasve pa funksione të tilla.



## **7. Analizë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për çështjet e korrupsionit të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit në Tiranë dhe Durrës, si dhe nga Gjykata e Krimeve të Rënda**

Gjyqësori luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe kontribuon në përmirësimin e përdorimit të fondeve publike dhe cilësisë së politikave publike, duke ndikuar në mënyrën se si shtetasit perceptojnë institucionet publike. Një gjyqësor transparent dhe me legjitimitet të lartë do të kishte më shumë efikasitet në luftën kundër korrupsionit.

Respektimi i të drejtës së informimit nga organet e pushtetit gjyqësor dhe transparenca e tij janë dy faktorë të rëndësishëm që ndikojnë dhe kontribuojnë në operativitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit dhe forcojnë mirëqeverisjen e tij.

Transparenca e gjyqësorit duhet të përfshijë jo vetëm publicitetin e seancave gjyqësore dhe publikimin e vendimeve, si dhe të të dhënave për çështjet e arkivuara dhe çështjet në proces, por njëkohësisht duhet t'i japë mundësi publikut, profesionistëve të së drejtës, gazetarisë, ekspertëve të shoqërisë civile dhe çdo personi të interesuar të ketë akses në vendimet gjyqësore, të cilat duhet të pasqyrojnë në mënyrë të plotë të gjitha elementet e kërkuara në Kodet përkatëse procedurale, si dhe duhet të jenë të arsyetuara. Në këtë mënyrë, do të rritej edhe debati dhe analiza profesionale për këto vendime.

### **7.1 Qëllimi, objekti dhe metodologjia e ndjekur**

Qëllimi kryesor i kësaj analize është evidentimi i të dhënave, gjetjeve dhe problematikave, që kanë rezultuar nga studimi i vendimeve gjyqësore për veprat penale në fushën e korrupsionit në sektorin publik, të dhëna nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatat e Apelit përkatëse.

Gjithashtu, kjo analizë synon të evidentojë problematikat dhe vështirësitë që ndeshin aktorët e sistemit të drejtësisë (avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë) në praktikën hetimore dhe gjyqësore si dhe sa i takon përmbajtjes, qartësisë dhe harmonisë së kuadrit ligjor të zbatueshëm për hetimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve.

Gjetjet dhe problematikat e evidentuara në këtë raport studimor, si dhe rekomandimet e drejtuara nga vetë aktorët e sistemit të drejtësisë në tryezën e rrumbullakët për konsultimin e këtij studimi, vlerësojnë se do t'i vijjnë në ndihmë debatit juridik që do të zhvillohet në mënyrë të veçantë për ndryshimet në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale. Sa më të qarta dhe të harmonizuara të jenë dispozitat materiale dhe procedurale penale, aq më e konsoliduar dhe e unifikuar do të jetë praktika hetimore dhe ajo gjyqësore, si dhe në mënyrë të veçantë efikasiteti i organeve të drejtësisë penale në luftën dhe ndëshkimin e veprave penale në fushën e korrupsionit.

**Objekti** i kësaj analize është praktika në vitet **2013-2014** e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës, si dhe e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit në sektorin publik. Fokusi në këtë Raport analitik është drejtuar në ato vepra penale që parashikojnë veprimet korruptive në mënyrë të drejtpërdrejtë, të përcaktuara në këto nene të Kodit Penal:


- Neni 244 *“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*,
- Neni 245 *“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”*,
- Neni 259 *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*,
- Neni 260 *“Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë”*,
- Neni 319 *“Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”* dhe,
- Neni 319/ç *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*.

Një ndër argumentet kryesore për objektin e kësaj analize të thelluar të vendimeve ka të bëjë me faktin, sipas të cilit, në një studim të kryer në vitin 2014, për vendimet e dhëna në periudhën 2007 - 2012 rezultoi se, në numrin e madh të veprave penale të konsideruara si vepra penale të korrupsionit këto dispozita pothuajse paraqiteshin me të dhëna statistikore të papërfillshme në krahasim me veprat e tjera, për shembull, shpërdorimi i detyrës ose vjedhje duke shpërdoruar detyrën.

Duke qenë se në disa nga çështjet penale për të cilat janë dhënë vendimet gjyqësore objekt i këtij studimi, disa të pandehur janë gjykuar me akuzën e veprave të tjera penale të lidhura me ato të korrupsionit aktiv, ose atë pasiv në sektorin publik, në këtë studim reflektohen të dhëna që prekin edhe këta të pandehur, të akuzuar kryesisht për veprat penale *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, *“Shpërdorim i detyrës”*, *“Mashttrim”* *“Moskallëzim i Krimit”*, *“Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”*, veprat penale në fushën e kontrabandës dhe doganave, etj.

Në aspektin metodologjik, kriteret për përzgjedhjen e vendimeve gjyqësore janë bazuar në veprat penale të kësaj analize, periudhën në të cilën janë dhënë, përkatësisht për vitet 2013 – 2014 dhe në gjykatat që i kanë dhënë, përkatësisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, si dhe Gjykata e Apelit të Tiranës. Gjithashtu janë marrë në shqyrtim edhe disa vendime të dhëna gjatë vitit 2014 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale, për kalimin në kompetencën lëndore të kësaj gjykate të 4 veprave penale në fushën e korrupsionit, (të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve të lartë, të të zgjedhurve vendor, si dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve), të cilat janë objekt i kësaj analize.


Kampioni i vendimeve gjyqësore që janë objekt i këtij studimi përfshin një total prej **48 vendimesh, ku janë gjykuar në cilësinë e të pandehurit 97 persona**. Vendimet gjyqësore të studiuara i përkasin më shumë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me 40 vendime. Kampioni tjetër i vendimeve të studiuara i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përkatësisht me 3 vendime, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përkatësisht me 3 vendime, dhe 2 vendime janë të Gjykatës së Apelit Tiranë.



**Paraqitja grafike Nr. 1 – Të dhëna për vendimet gjyqësore dhe numrin e të pandehurve**  
Duke bërë një krahasim me studimin e mëparshëm të Komitetit Shqiptar të Helsinkit<sup>18</sup> të publikuar në vitin 2014, vërehet i njëjti raport midis numrit të vendimeve gjyqësore dhe numrit të të pandehurve, përkatësisht sipas një mesatare që vlerësohet në shkallën një vendim gjyqësor për çdo dy të pandehur.

<sup>18</sup> Studim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, "Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës", Tiranë 2014, shtëpia botuese 'Vllamasit'. Studimi u fokusua në vendimet gjyqësore të formës së prerë për 21 veprat penale të korrupsionit, për periudhën 2007 – 2012 në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Grupi i ekspertëve të angazhuar studioi 48 vendimet gjyqësore të veprave penale që lidhen drejtpërdrejtë me korrupsionin pasiv dhe atë aktiv të zyrtarëve të lartë, të të zgjedhurve vendor, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Fokusi i kësaj analize ka qenë nga njëra anë, përfitimi dhe përpunimi i të dhënave të ndryshme statistikore të cilat të çojnë në konkluzione të rëndësishme. Nga ana tjetër i është kushtuar rëndësi e veçantë analizës cilësore së vendimeve gjyqësore pa u përfshirë në analizën e bindjes së brendshme të gjyqtarit. Kjo analizë cilësore synon të evidentojë problematikat dhe defektet e praktikës gjyqësore dhe asaj hetimore, dhe nuk ka qëllim të shprehë bindje apo pikëpamje mbi drejtësinë apo jo të vendimit gjyqësor, duke respektuar parimin e rëndësishëm të pavarësisë së sistemit gjyqësor.



*Paraqitja grafike Nr. 2 – Të dhënat e vendimeve të vitit 2007 – 2012 për krahasim me të dhënat e periudhës objekt shqyrtimi i këtij studimi (2013 – 2014)*

## 7.2 Respektimi i aspektit formal dhe procedural të zbardhjes së vendimit

Bazuar në nenin 383, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, vendimi i gjykatës përmban disa elementë që duhen respektuar në aspektin procedural dhe formal të saj: a) gjykatën që e ka dhënë; b) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private; c) akuzën; ç) parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta; d) dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit; dh) datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.

Në vendimin Nr. 262/2 të KLD-së është përcaktuar ndër grupet e kritereve të vlerësimit për veprimtarinë e përgjithshme të punës së gjyqtarëve “kriteri i hartimit të vendimeve të qarta”. Ky kriter teston aftësitë e një gjyqtari për përgatitjen e vendimeve gjyqësore në mënyrë të qartë dhe të

thjeshtë, në mënyrë që vendimi të jetë i thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë. Gjithashtu ky kriter shërben për të vlerësuar aftësinë e gjyqtarit për të menaxhuar një proces të rregullt gjyqësor, për të orientuar dhe drejtuar drejt debatin ligjor dhe për t'u shprehur qartë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të etikës ligjore. Gjithashtu, ai kërkon që vlerësuesi të vlerësojë kompetencën e gjyqtarit për të krijuar dhe për të organizuar një dosje gjyqësore në një mënyrë që e bën atë gati për përdorim.

Nga kampioni i vendimeve gjyqësore të studiuara, rezulton se tendenca e gjykatës është të mos paraqesë një tablo të përmbledhur të çështjes së gjykuar dhe në mënyrë të veçantë të rrethanave procedurale të çështjes, rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në gjykim, analizës ligjore të provave dhe pretendimeve të palëve në proces, etj. Vihet re se gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda kanë shkruar vendime më të plota dhe më të arsyetuara në raport me vendimet e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Tiranë dhe Durrës. Kjo në të shumtën e rasteve justifikohet dhe me ngarkesën e këtyre gjykatave e cila është më e lartë se ajo e Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Është evidentuar nga studimi i vendimeve se në shumicën e vendimeve gjyqësore nuk pasqyrohet qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur, veprimet hetimore që janë kryer nga prokuroria dhe numri i personave të hetuar. Vendimet e gjata jo detyrimisht janë vendime të mira dhe anasjelltas. Kjo do ta bënte më transparente vendimmarrjen e gjykatës ndaj publikut si dhe do t'i mundësonte analistëve të fushës një akses më të plotë dhe rrjedhimisht një analizë më gjithëpërfshirëse të vendimeve gjyqësore për ndëshkueshmërinë e veprave penale në fushën e korrupsionit.


**Shembull ilustrues 1:** Në vendimin Nr. xxx., dt.03.04.20xx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se janë vënë nën akuzën e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike 3 persona, dhe 6 të tjerë nën akuzën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. Nga faktet dhe rrethanat e pasqyruara në këto vendime provohet që personat e akuzuar kanë përfituar në mënyrë të paligjshme nga drejtues të automjeteve për kontrollin teknik të këtyre automjeteve, çka hedh dyshime për konsumimin nga ana e drejtuesve të automjeteve të elementëve të figurës së veprës penale të korrupsionit aktiv. Nga vendimi, nuk rezulton që drejtues automjeteve të jenë hetuar ose gjykuar për korrupsion aktiv, ndërkohë që rezulton e provuar sipas fakteve të renditura në vendim se, personat e akuzuar kanë pasur përfitime materiale në të holla.

Duke i konsideruar si vepra penale me rrezikshmëri të lartë, ajo që ka dhe duhet të ketë rëndësi për gjykatën dhe për prokurorinë gjatë procesit të hetimit, si dhe gjatë procesit gjyqësor të gjykimin të veprave penale të korrupsionit, është marrja dhe pasqyrimi në vendim i informacionit nëse i akuzuari ka të dhëna kriminale të mëparshme për konsumimin e të njëjtave

veprave penale. Nga vendimet e studiuara u evidentua se ky informacion nuk gjendej në asnjë prej tyre. Vendimet e studiuara reflektojnë se vetëm 6 të pandehur janë recidivistë, por pa specifikuar nëse i pandehuri/e pandehura është dënuar ose jo për vepra penale në fushën e korrupsionit.

### 7.3 Gjendja gjyqësore e të pandehurve

Nga të dhënat e përpunuara, rezultoi se gjendja gjyqësore e të pandehurve të gjykuar me akuzën e veprave penale në fushën e korrupsionit në sektorin publik, si dhe të veprave penale të lidhura me to është si vijon: përkatësisht, 89 të pandehur të padënuar më parë, 5 të pandehur të dënuar më parë, 1 i dënuar i rehabilituar, dhe për 2 të pandehur mungon informacioni.




*Paraqitja grafike Nr.3 – Gjendja gjyqësore e të pandehurve të gjykuar për veprat penale të korrupsionit për vendimet gjyqësore të periudhës 2013 - 2014*

Lidhur me të dhënat nëse të pandehurit kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale të korrupsionit, ashtu sikurse u përmend më herët në këtë Raport, ky informacion nuk figuronte në vendimet gjyqësore.


### 7.4 Masat shtrënguese për të pandehurit

Masat shtrënguese, të cilat janë zbatuar ndaj të gjithë të pandehurve, në çështjet penale ku një ose disa prej tyre kanë qenë të akuzuar për veprat penale në fushën e korrupsionit në sektorin publik, rezultojnë të jenë të ndryshme. Masat shtrënguese që janë aplikuar më shumë janë “arrest me burg”, pasuar nga masa “arrest në shtëpi”, masa shtrënguese të alternuara apo garanci pasurore. Masa e sigurimit më pak e aplikuar është “detyrimi për paraqitje” dhe pjesa tjetër e të pandehurve është gjykuar në gjendje të lirë. Referuar nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale, të pa aplikuar rezultojnë masat e tjera shtrënguese të parashikuara nga kjo dispozitë, përkatësisht “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, “ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar”, “shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”.



*Paraqitja grafike Nr.4 – Masat shtrënguese për të pandehurit për vendimet gjyqësore të periudhës 2013 – 2014*

Po të bëjmë një krahasim me studimin e vendimeve të viteve 2007 – 2012, rezulton se më së shumti të pandehurit janë gjykuar në gjendje të lirë, dhe në numër më të ulët figurojnë të pandehurit e gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”, “arrest në shtëpi”, etj. Megjithatë, kjo analizë krahasuese nuk bëhet në kushte të njëjta, për shkak të numrit më të gjerë të veprave penale të korrupsionit të përfshira në studimin e periudhës 2007 – 2012. Paraqitja grafike si më poshtë:



*Paraqitja grafike Nr.5 – Masat shtrënguese për të pandehurit (punonjës të sektorit publik) për vendimet gjyqësore të dhëna në periudhën 2007 – 2012*



## 7.5 Subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal

Bazuar në parashikimet e nenit 280 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet që prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vetë dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët, ndërkohë që sipas parashikimeve të nenit 281/1 të K.P., “Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale”.


Kallëzimet kryesisht bëhen nga personat e dëmtuar. Si problematikë e përgjithshme evidentohet që cilësia e kallëzimeve apo referimeve të veprave penale të korrupsionit është e ulët.

Nga studimi i vendimeve gjyqësore ka rezultuar se, në një sërë procedimesh penale subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal kanë qenë persona të cilëve u është mohuar një e drejtë e parashikuar nga ligji. Këtyre subjekteve u është kërkuar shpërblim i paligjshëm për ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave me qëllim marrjen e shpërblimit të paligjshëm.

Në një numër vendimesh rezulton se, kallëzimi bëhet kur i dëmtuari dhe i pandehuri nuk bie në marrëveshje për vlerën e shpërblimit, ose kur janë në pamundësi financiare për të shlyer atë. Ka raste kur i dëmtuari e ka bërë kallëzimin pasi ka shlyer pjesërisht një pjesë të përfitimit material të veprës penale, ndërkohë që subjektet e veprës kanë kërkuar pagimin e një shume më të madhe.

Gjithashtu është evidentuar në krahasim me studimin e mëparshëm, se në disa procedime penale, subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal nëpërmjet denoncimit publik të veprimeve të kundërligjshme të zyrtareve për veprat penale të korrupsionit ka qenë gazetaria investigative, përkatësisht emisionet televizive të realizuara nga kjo gazetari.

Të dhënat statistikore për subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin paraqiten në formën grafike si vijon:



**Paraqitja grafike Nr.6** – Subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin për vendimet gjyqësore të periudhës 2013 – 2014

Si konkluzion të përgjithshëm evidentojmë se, numri më i madh i procedimeve penale ka filluar me kallëzim nga shtetasit që kanë pësuar një dëm. Të pakta janë rastet e kallëzuara nga zyrtarët, ose të referuara nga Policia, dhe pothuajse në asnjë rast nga vendimet e studiura nuk ka rezultuar që procedimi të ketë filluar me iniciativë nga Prokuroria.

Duke marrë në konsideratë që në këtë analizë theks të veçantë i është dhënë përmbajtjes së vendimeve për efekt studimi, në vijim gjenden të ilustruar disa shembuj që evidentojnë gjetjet e prezantuara në këtë pjesë të raportit<sup>19</sup>.

**Shembull ilustrues 1:** Në një çështje të gjykuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, për korrupsion pasiv të një gjyqtari<sup>20</sup>, vërehet se pala e dëmtuar pranon në deklaratimet para policisë se do ta pranonte shumën e kërkuar nga gjyqtari që ai të hiqte dorë nga gjykimi i një çështje civile ku ajo ishte palë, por e dëmtuara nuk kishte lekë.

**Shembull ilustrues 2:** Bazuar në vendimin nr. xx, dt. 21.xx.20xx, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ku është deklaruar fajtor për korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë publik, kryetari i një komune në qarkun e Tiranës dhe nëpunësi i tij, vërehet se kallëzimi është bërë nga i dëmtuari i cili kërkonte të merrte një sipërfaqe toke në përdorim nga kjo Komunë, pasi ka paguar mitën prej 1000 euro, ndërkohë që i janë kërkuar edhe 3500 euro të tjera.

**Shembull ilustrues 3:** Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. Xxx, dt. 24.xx.2xxx, Prokuroria ka dërguar për gjykim në cilësinë e të pandehurit

<sup>19</sup> Me qëllim zbatimin e parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, një pjesë e vendimeve do të jepen si shembuj ilustrues, duke kodifikuar emrat, numrat e vendimeve dhe datat e tyre.

<sup>20</sup> Vendimi nr. xxx, dt. 1x. xx.201x, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë

*juristen e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe personin që ka bërë kallëzim penal, pasi është pajisur me certifikatë pronësie nga e pandehura kundrejt një shume të hollash. Arsyeja përse është bërë kallëzim konsiston në faktin se, certifikata e marrë kishte për objekt një sipërfaqe tjetër toke nga ajo e kërkuar. Në analizën e provave mbi fajësinë e të pandehurve, Gjykata vlerëson se i pandehuri ka kallëzuar faktin kriminal të ndodhur, por koha e kallëzimit i përket periudhës mbas pajisjes me certifikatë të të pandehurit. Në kallëzimin e vet, ai nuk ka pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit nga veprimet kriminale, por rregullimin e situatës së tij juridike dhe eliminimin e pasojave ekonomike që i kanë ardhur.*

## **7.6 Analizë mbi pranimin e kërkesave për gjykim të shkurtuar**

Ajo që vihet re nga studimi i vendimeve është se numri i të pandehurve të gjykuar me gjykim të shkurtuar për veprat penale objekt i këtij raporti studimor është në numër të konsiderueshëm. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezultoi se, në rreth 69% të gjykimeve (duke përfshirë këtu edhe rastet e disa të pandehurve në gjykim) është proceduar me gjykimin e shkurtuar, që sipas Kodit të Procedurës Penale është gjykim i posaçëm.

Në Vendimin Unifikues nr.2, dt. 29.01.2003, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me qëllim njehsimin e praktikës gjyqësore çmuan, se: *“Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Është e rëndësishme të theksohet fakti që ky përfitim nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Për këtë qëllim, kërkesën e të pandehurit ose mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë kur ajo paraprakisht bindet se mund ta përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për t’ia nënshtruar ato shqyrtimit gjyqësor”.*


Vendimet gjyqësore të studiuara nuk mundësonin bërjen e një analize mbi bindjen paraprake të gjykatës përsa i takon dhënies së gjykimit të shkurtuar. Kjo për arsye se, në një kampion prej 15 vendimesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 3 vendimesh të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe 3 vendimesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës u vërejt që, në më shumë se gjysmën e këtyre vendimeve nuk pasqyroheshin argumente rreth bindjes së gjykatës nëse çështja mund të përfundonte në gjendjen që ishin aktet e Prokurorisë, pa qenë nevoja për t’ia nënshtruar ato shqyrtimit gjyqësor. Gjatë tryezës së rrumbullakët të zhvilluar me aktorë të sistemit të drejtësisë dhe përfaqësues të institucioneve të interesuara për konsultimin e këtyre gjetjeve, disa prej të pranishmëve referuan se, gjykata nuk ka detyrim të argumentojë apo të arsyetojë dhënien e vendimit për gjykimin e shkurtuar.

Nga publikimi i mëparshëm i KShH-së për studimin e vendimeve gjyqësore të periudhës 2007 – 2012, rezultojnë se 60 % e çështjeve janë gjykuar me gjykim të shkurtuar. Në aspektin krahasimor, vërehet se ka një rritje me 9% të rasteve të gjykimit të shkurtuar në kampionin e vendimeve të studiuar në këtë raport.


Gjykimi i shkurtuar aplikohet në çështjet penale pa bërë diferencim për vepra penale të caktuara. Në tryezën e rrumbullakët për konsultimin e këtij raporti, ekspertë të fushës referuan se në shkallë vendi, gjykimi i shkurtuar zbatohet për 80 % të çështjeve penale dhe ajo që rezultojnë më së shumti në këto procese është se cilësia e hetimit nuk është në nivelin e duhur. Rrjedhimisht, kjo cilësi prek edhe provat e siguruara gjatë hetimit dhe që janë ato

te të cilat gjykata duhet të mbështetet në dhënien e vendimit. Ajo çka dëshirojmë të shtrojmë për diskutim në këtë Raport është se, statistikave dhe praktika hetimore dhe ajo gjyqësore ka diktuar nevojën për ndryshime në legjislacionin tonë procedural, me qëllim që të përjashtohen nga gjykimi i shkurtuar disa persona ose vepra penale me rrezikshmëri të lartë, duke mos i lënë diskrecion të gjerë gjykatës. Në kushtet kur gjykata nuk ka as detyrimin për të materializuar arsyet për pranimin e këtij vendimi, kjo e përforcon tezën për nevojën e ndryshimeve të propozuara në këtë paragraf.

Në disa vendime janë vënë re se, kur ka pasur më shumë se një të pandehur dhe ndonjë prej tyre ka kërkuar gjykim të shkurtuar, gjykata ka vendosur për ndarjen e çështjes për të pandehurin që ka kërkuar gjykimin e shkurtuar. Me argumentimin se, çështja për këtë të pandehur zgjidhet në gjendjen që janë aktet, dhe për të pandehurit e tjerë nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve, për rritjen edhe të shpejtësisë në këtë gjykim, duke proceduar me gjykim të shkurtuar dhe duke vendosur ndarjen e çështjes për të pandehurin që ka kërkuar gjykim të shkurtuar.



*Paraqitja grafike Nr.7 – Proceset gjyqësore me gjykim të shkurtuar të studimit të vendimeve gjyqësore të periudhës 2013 – 2014*



*Paraqitja grafike Nr.8 – Proceset gjyqësore me gjykim të shkurtuar të studimit të vendimeve gjyqësore të periudhës 2007 – 2012*

Në ndonjë rast tjetër, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, duke vlerësuar se në gjendjen që ndodheshin aktet nuk mund të vijohej me këtë lloj gjykimi, për shkak të mungesës së akteve shkresore që vërtetonin detyrën funksionale të secilit prej të pandehurve në organet shtetërore përkatëse, e lidhur ngushtë kjo me hetimin gjyqësor. Kjo është evidentuar edhe në ato raste kur ndonjë nga të pandehurit e tjerë në të njëjtën çështje penale, si dhe për shkak të zhvillimit të gjykimit në mungesë të të pandehurit tjetër, për të cilin detyrimisht do të procedohej me gjykim të zakonshëm, referuar edhe praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Në konkluzion të përgjithshëm mund të themi se, pavarësisht një praktike unifikuese të Gjykatës së Lartë për gjykimin e shkurtuar, përsëri hasen praktika të ndryshme në gjykimin dhe në argumentimin e pranimit, ose rrëzimit të kërkesave për një procedurë të tillë.

## **7.7 Shkaqet e zvarritjeve të seancave gjyqësore për ato çështje që kanë zgjatur mbi mesataren**

Nga studimi i kalendarëve të çështjeve penale të korrupsionit evidentohet se, procesi gjyqësor në disa raste zhvillohet tej afateve mesatare të parashikuara për gjykimin e çështjeve të tilla. Ndërkohë numri i seancave gjyqësore në disa prej këtyre çështjeve vihet re që është tejet i lartë. Nga kalendarët e këtyre çështjeve penale, por edhe nga vendimet gjyqësore të studiuara, nuk rezulton nëse shkaqet e shtyrjes janë të justifikuara dhe të përligjura sipas Kodit të Procedurës Penale. Pjesërisht kjo vjen edhe për shkak të metodologjisë së ndjekur për kryerjen e kësaj analize, e cila nuk ka pasur objekt dosjet dhe fashikujt e gjykimit, por vetëm vendimet gjyqësore përfundimtare.

Në më të shumtën e rasteve, proceset gjyqësore kanë qenë të tej zgjatura për arsye të shtyrjes së seancave gjyqësore. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ardhur për shkak të mungesës së trupit gjykues, të prokurorit, të të pandehurit, të avokatit mbrojtës, të dëshmitarëve, etj. Por, gjithashtu është evidentuar që një numër seancash gjyqësore janë shtyrë për shkak të kërkesave të të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, për të pasur kohë për provat, për njohjen me aktet, për mungesë të njoftimit të palëve të ndryshme në proces nga mosfunksionimi i mirë i sistemit të adresave etj.


Nga studimi i kalendarëve të çështjeve gjyqësore është evidentuar se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për gjykimin e të pandehurve për 6 veprat penale të korrupsionit varion mesatarisht në nga 10 ditë (në një rast) deri në 250 ditë. Përrjashtimisht ka pasur raste kur proceset gjyqësore

në një shkallë gjykimi kanë zgjatur 400 – 500 ditë, ose në ndonjë rast edhe më shumë se 1000 ditë.

Në disa çështje rezulton se, prokurori mungon në gati gjysmën e seancave gjyqësore, duke u bërë shkak për shtyrjen e njëpasnjëshme të seancave gjyqësore. Në çështjen penale nr. x11, gjykuar me vendimin nr.2xxx, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 22 seanca të zhvilluara, 10 prej tyre janë shtyrë për shkaqe të lidhura kryesisht me mos prezencën e prokurorit në çështje.

Por, gjithashtu janë evidentuar edhe raste haptazi në kundërshtim me aspektet procedurale të zhvillimit të një seance gjyqësore, kur shtyrja është arsyetuar me kohën që i nevojitet trupit gjykues për shpalljen e vendimit përfundimtar, dhe më pas rezulton që në seancën e radhës është vendosur sërish shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit përfundimtar, për t'i dhënë kohë prokurorit që të vërë në dispozicion të trupit gjykues dëshminë e penaltetit të të pandehurit.

Nga studimi i kalendarëve të çështjeve penale të korrupsionit për një kampion prej 15 vendimesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 3 vendimesh të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se shtyrja e seancave gjyqësore bëhet për këto shkaqe, të kategorizuara:



**Paraqitja grafike Nr.9 – Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore në një kampion prej 15 çështjesh.**

Duke e krahasuar me problematikën e evidentuar në studimin e vendimeve gjyqësore të vitit 2007 – 2012, të dhënat që rezultojnë nga studimi i vendimeve përkatëse për vitet 2013 – 2014 nuk paraqesin përmirësim. Kjo do të thotë që efiçenca e gjykatave është në nivele të ulëta, duke cënuar në këtë mënyrë të drejtën e të pandehurve për një gjykim brenda një



afati të arsyeshëm dhe duke rritur kostot e gjykatës, por dhe të sistemit penitenciar. Pasojat për të pandehurin janë të rënda sidomos kur ai/ajo gjykohet me masë sigurie “arrest në burg”.

Duke marrë në konsideratë që në këtë analizë theks të veçantë i është dhënë përmbajtjes së vendimeve për efekt studimi, në vijim gjenden të ilustruar disa shembuj që evidentojnë gjetjet e prezantuara në këtë pjesë të raportit

**Shembull ilustrues 1:** Në çështjen gjyqësore me të pandehur një gjyqtar të akuzuar për korrupsion pasiv (319/a), pas kërkesave të vazhdueshme të tij për përjashtim të trupit gjykues dhe zvarritjes së gjykatës për t’u shprehur me një vendim të arsyetuar në një kohë sa më të shpejtë, një nga seancat gjyqësore rezultoi të jetë shtyrë, pasi vetë trupi gjykues i kërkon kryetarit të gjykatës të dorëhiqet nga shqyrtimi i kësaj çështje. Sipas kalendarit të kësaj çështje, kjo kërkesë e trupit gjykues bazohet në një kërkesë indirekte të vetë të pandehurit për përjashtim. Në kalendarin e çështjes parashihet se trupi gjykues e mbështet kërkesën e tij për dorëheqje bazuar në nenin 17 të K.Pr.P, me qëllim që të shmangen dyshimet e të pandehurit në lidhje me paanshmërinë.<sup>21</sup> Analiza e bërë nga KShH evidenton se, kjo kërkesë e trupit gjykues nuk është e bazuar në asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 17 të K.Pr.P. Duhet të saktësojmë se kjo dispozitë nuk parashikon dorëheqjen thjesht për shkak të kërkesave të të pandehurve por nëse ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie. Në këtë çështje janë zhvilluar 51 seanca gjyqësore dhe vendimi i gjykatës është marrë pas tre vite e dy muaj, nga ku rezultuan të pafajshëm, të dy të pandehurit, duke përfshirë edhe gjyqtarin e dyshuar për korrupsion. Rreth 40% e seancave të kësaj çështje janë shtyrë për shkaqe të lidhura me prokurorin, të cilat në të shumtën e rasteve nuk rezultojnë të justifikuar sipas kalendarit të çështjeve. Në ato raste kur prokurori përdor argumenton shtyrjen e seancave, rezultoi se motivi i tyre është i njëjtë dhe se nuk përbën justifikim për shtyrjen e herëpashershme të tyre. I njëjti konstatim vlen edhe për rastet kur seancat janë shtyrë me kërkesë të të pandehurit, i cili kërkon në mënyrë të vazhdueshme përjashtim të trupit gjykues, duke përbërë rrjedhimisht një shkak të mjaftueshëm për trupin gjykues, për të shtyrë seancat gjyqësore.

## 7.8 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

### a) Argumentimi i provave në vendimet gjyqësore

Sipas nenit 142 të Kushtetutës, vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Në vendimin nr. 100, datë 1.2.2001, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar rekursin e të gjykuarit F.A, të gjykuar nga Gjykata

<sup>21</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. xxx, dt. 08.07.20xx.



e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe, ka prishur vendimin e asaj gjykate, duke arsyetuar: *“Gjykata duhet t’i përmbahet kërkesës së ligjit lidhur me përmbajtjen e vendimit, domethënë të elementeve përbërës të tij...Një ndër to është edhe detyrimi i gjykatës për të parashtruar në vendimin e saj, në mënyrë të përmbledhur, rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta. Si në vendimin e gjykatës së rrethit, ashtu edhe në atë të apelit nuk parashtrohen këto elemente për një episod të krimit.”*

Kryesisht provat e referuara në vendim për të provuar fajësinë e të pandehurve janë ato të marra nëpërmjet përgjimit në ambiente publike, përgjimit të telefonatave, përgjimeve të fshehta fotografike, filmike ose me video, kryerjes së veprimeve simulative, ushtrimit të kontrollit personal, të kontrollit të banesës.

Në disa prej vendimeve gjyqësore, rezulton se provat e siguruara gjatë procesit hetimor dhe të administruara gjatë gjyqimit janë kontestuar për shkak të vlefshmërisë së tyre. Gjykata ka çmuar se rezultatet e këtyre provave janë të papërdorshme me arsyetimin se janë marrë në kundërshtim me ligjin. KSHH evidenton se në këto raste ku provat janë të kontestueshme, organi i prokurorisë duhet të kishte kryer hetime më të plota, efektive dhe të gjithëanshme. Deklarimi i provave të siguruara gjatë hetimit si të papërdorshme në disa nga vendimet objekt i këtij raporti studimor, vë në pikëpyetje cilësinë e hetimeve të veprave penale në fushën e korrupsionit.

Në disa raste gjykata nuk merr në analizë as në mënyrë të përmbledhur provat mbi të cilat mbështeten faktet e referuara në vendimin gjyqësor, duke u mjaftuar në disa raste me citimin e provave shkresore dhe procesverbalet e deklaratave të shtetasve të pyetur nga prokuroria por pa bërë referime të fakteve mbi të cilat hedhin dritë këto prova.

Pavarësisht faktit që secila çështje ka specifikat dhe kompleksitetin e saj, ajo që evidentohet në mënyrë të qartë, është se çdo vendim i studiuar përbën një rast të veçantë në mënyrën e argumentimit të shqyrtimit të ligjshmërisë së marrjes së provave si dhe në mënyrën e provueshmërisë së fajësisë në bazë të tyre. Për efekt studimi, në këtë raport studimor do të trajtojmë disa raste (me të dhëna të koduara), pa pasur si qëllim dhënien e vlerësimeve sa i takon drejtësisë së këtyre vendimeve apo fajësisë ose jo të të pandehurve. Këto raste synojnë të evidentojnë në linja të përgjithshme dhe problematikat që shfaq praktika hetimore dhe gjyqësore në këndvështrimin tonë.

**Shembull ilustrues 1** - Në një çështje penale të gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehuri, me profesion mjek “okulist” është gjykuar me akuzën e ngritur nga Prokuroria për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”.

Në vendimin gjyqësor i pandehuri deklarohet i pafajshëm. Nga të dhënat e hetimit gjyqësor evidentohet se i pandehuri në përfundim të vizitave mjekësore u merrte pacienteve pagesa, pa i dokumentuar ato me fatura dhe në regjistrin përkatës të vizitave. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga punonjësit e policisë bien ndesh me Nenin 294/a të Kodit të Procedurës Penale “Veprimet Simuluese” që parashikon se “Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke e shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë”. Gjykata referon si fakt, se në vendimin për delegimin e kompetencave të prokurorit është konkluduar se të tre aktet korruptive për këtë çështje janë të provokuara, çka vë sërish në pikëpyetje ligjshmërinë dhe efektshmërinë e veprimeve hetimore të kryera nga organi i akuzës.

**Shembull ilustrues 2** - Duke ju referuar vendimit nr. 1xxx, dt. 25.06.20xx, vërehet se nuk ka një qëndrim të unifikuar të gjykatës sa i takon përdorimit të rezultateve të provave të marra nëpërmjet përgjimit, edhe kur ky është lejuar me vendim të organit procedues. Në këtë çështje, në bisedën e përgjuar midis oficerit të policisë gjyqësore dhe të pandehurit, prokuroria pretendoi se i pandehuri do të bënte kalimin e një shtetase në pikën e kalimit kufitar Rinas, pavarësisht se ajo kishte problem me qëndrimin në vendet shengen të Europës, kundrejt pagesës 500 euro, të cilën ia kishte kërkuar shtetases nëpërmjet mikut të saj. Gjykata vlerëson, se nga biseda e zhvilluar mes të pandehurit, agjentit të policisë gjyqësore dhe shtetasit të tretë, rezulton se është përmendur një shumë prej 500 euro, por nuk del e qartë përfituesi dhe për çfarë. Nga faktet e cituara në këtë vendim, ekspertët e KSHH-së vunë re se biseda e regjistruar evidenton se shuma është kërkuar për kalimin e shtetases për në Francë. Ndërkohë sa i takon vlerësimit të gjykatës se nuk rezulton kush është përfituesi, neni 259 i Kodit Penal, parashikon se “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Nga interpretimi i dispozitës nuk kërkohet që të përcaktohet detyrimisht se për kë do të shkojë përfitimi i parregullt por mjafton të vërtetohet “Kërkimi ose Marrja”.

**Shembull ilustrues 3:** Në çështjen penale të gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. Regjistri nr.xxxx, dt. regjistrimi 01.08.20xx, të pandehurit e punësuar në pikën doganore personave të ----- dhe pronari i një shoqërie tregtare në fushën e ----- akuzoheshin për korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike dhe kontrabandë me mallrat që paguhet akcizë, duke evaduar nga magazina doganore mallra që në momentin e evadimit ishin me status të pa zhdoganuar. Përfaqësuesi i akuzës në këtë çështje ka pretenduar se pronari i shoqërisë tregtare, ka premtuar në mënyrë të vazhdueshme përfitime të parregullta doganierëve të zyrës doganore të -----, duke kërkuar nga ana e tyre kryerjen e veprimeve të parregullta ose kryerjen e veprimeve para doganës në mënyrë sa më të shpejtë, për të favorizuar subjektin e tij. Gjithashtu, ai akuzohet

se i ka kërkuar eprorëve të zyrës doganore të caktonin pranë magazinës doganore, doganierët e kërkuar nga vetë ai. Lidhur me këtë të pandehur, gjykata çmon se ai duhet të deklarohet i pafajshëm për të dyja veprat penale, për të cilat akuzohet (244 dhe 172 i Kodit Penal), pasi të vetmet të dhëna ku akuza mbështet pretendimin e fajësisë janë transkriptet e bisedave telefonike të përgjuara, të dhëna të cilat nuk lidhen me asnjë provë tjetër të shqyrtuar nga gjykata.

Në këtë vendim të Gjykatës së Durrësit, argumentimi i provave për fajësinë ose jo të pronarit të shoqërisë tregtare dhe punonjësve të Zyrës doganore të ----- mbështetet vetëm tek materialet e përgjimit të bisedave telefonike midis të pandehurve. Ndërkohë që në pjesën e fundit të këtij vendimi citohen edhe prova të tjera të cilat nuk i shqyrtohen analizës dhe arsyetimit të gjykatës, të tilla si "Shkresa e degës së doganës ----, për shkeljet e konstatuara nga shoqëria tregtare në fushën e -----, raporti i kontrollit dhe akt verifikimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave gjatë kontrollit të magazinës për këtë subjekt, të dhënat për pasqyrat financiare dhe librat e blerje-shitjeve të kësaj shoqërie, etj. Mënyra se si është bërë arsyetimi i provave të administruara në këtë proces gjyqësor, duke cituar vetëm ato të transkripteve të bisedave të përgjuara, nuk përçon tek publiku dhe profesionistët e së drejtës, bindjen sa i takon paanshmërisë së trupit gjykues. Gjithashtu, mbi të njëjtat prova mbi të cilat organ i prokurorisë akuzon 4 punonjësit doganorë dhe përfaqësuesin e shoqërisë tregtare, për korrupsion aktiv të punonjësve që ushtrojnë funksione publike, shpërdorim detyre dhe kontrabandë me mallrat për të cilat paguhet akcizë, Gjykata çmon se vetëm dy prej këtyre të pandehurve gjenden fajtorë për veprën penale të kontrabandës, duke deklaruar të pafajshëm drejtuesin e shoqërisë së hidrokarbureve dhe duke pushuar çështjen penale për të pandehurit e tjerë.

**Shembull ilustrues 4** - Në çështjen penale nr. X, dt. regjistrimi 30.04.20xx, me të pandehur një gjyqtar të akuzuar për korrupsion pasiv, prokuroria ka paraqitur në cilësinë e provës një mini disk ku janë regjistruar bisedat e bëra mes gjyqtarit dhe familjarit të një shtetasi, të gjykuar në një çështje tjetër prej gjyqtarit të akuzuar (për shkak të funksionit). Në vendimin e saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin e saj nr. x, dt. 08.07.20xx vlerësoi se "mini disku me inçizim zëri" është një përgjim jo procedural dhe si i tillë ai nuk mund të përdoret. Por dhe si një përgjim i marrë në formën e një prove atipike, ai nuk plotëson kushtet e kërkuara nga neni 151/3, për t'u marrë si provë nga Gjykata, pra nuk është dhe nuk mund të merret dhe vlerësohet si provë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë shpall të pafajshëm dy të pandehurit, gjyqtarin e Gjykatës së Elbasanit dhe babain e personit të dënuar nga i pandehuri, i cili rezulton i regjistruar me zë mini disk.

Nga studimi i këtij rasti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit vëren se:

- a) Organi i prokurorisë mund të kishte kryer hetime më të plota, efektive dhe të gjithanshme pasi në rastin konkret është proceduar penalisht dhe dërguar për gjykim një gjyqtar nën akuzën e korrupsionit, kur ndërkohë

*në realitetin e vendit tonë, perceptimet dhe ndjeshmëritë e qytetarëve për korrupsionin në radhët e gjyqësorit dhe pandëshkueshmërinë e tij vlerësohen si të larta;*

- b) *Gjykata vlerëson se përmbajtja e mini diskut nuk mund të dëgjohej dhe rrjedhimisht as të vërtetonte faktet, ndërkohë që përmbajtja e këtij mini disku rezulton të jetë transkriptuar nga organi i akuzës;*
- c) *Gjykata vlerëson se mini disku mund të jetë marrë jashtë vullnetit të personave dhe rrjedhimisht ka cënuar privatësinë e tyre. Në fakt neni 151/3 i Kodit të Procedurës Penale parashikon si kriter faktin që prova atipike nuk duhet të çenojë lirinë e vullnetit të personit. Fakti që ky regjistrim nuk rezulton të jetë bërë me miratim të personave të incizuar nuk provon që ai ka cënuar lirinë e vullnetit të tyre. Cënimi i lirisë së vullnetit nënkupton rastet kur personat detyrohen me mjete dhe forma të paligjshme të deklarojnë fakte apo të dhëna të cilat nuk i përgjigjen vullnetit të tyre. Ndërkohë që e drejta e privatësisë, ashtu sikurse të drejtat e tjera nuk janë të pacënueshme. Neni 17/1 i Kushtetutës parashikon kufizimin e këtyre të drejtave vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.*

#### **b) Pasqyrimi në vendim i argumenteve të mbrojtjes dhe të akuzës**

Analiza e vendimeve evidenton se, në më të shumtën e rasteve argumentet ligjore të mbrojtësit të të pandehurit dhe organit të akuzës pasqyrohet te vendimet gjyqësore të studiuara. Megjithatë, në disa nga këto vendime pasqyrimi i argumenteve nuk bëhet në mënyrë të plotë, por përmbledhet shkurtimisht dhe mungon arsyeimi se përse gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.

Në këtë drejtim, praktikat pozitive janë të pakta dhe mund të përmendet si një shembull pozitiv, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nr. xxx, dt. 26.xx.201x, ku analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet e mbrojtjes për dy të pandehurit e kësaj çështje (*një prej të cilëve gjyqtarë dhe tjetri avokat*) dhe gjykata jep argumentet përkatëse nëse qëndrojnë këto pretendime apo jo, duke i ballafaquar edhe me konkluzionet që rezultojnë nga vlerësimi që gjykata i bën provave të administruara në këtë proces.

Gjithashtu, evidentohen raste ku vendimet gjyqësore nuk pasqyrojnë asnjë nga pretendimet e palëve në proceset gjyqësore penale të veprave penale në fushën e korrupsionit.

#### **c) Pasqyrimi i analizës së elementëve të figurës së veprës penale**

Në shumicën e vendimeve gjyqësore të studiuara rezulton se janë pasqyruar elementet e figurës së veprës penale. Por analiza e elementëve

të figurës së veprës penale në vendimet e gjykatave ka rëndësi për të kuptuar mënyrën e arsytimit të gjykatës, kualifikimit të veprës penale nga prokurori në paraqitjen e akuzës apo nga vetë gjykata nëse vepra penale ka një kualifikim ligjor të ndryshëm prej saj.

Evidentohet se në shumicën e vendimeve, analiza e elementëve të figurës është kryer shkurtimisht ose nuk është kryer fare. Në raste të veçuara por si shembuj pozitiv në këtë raport studimor, elementët e figurës së veprave penale në fushën e korrupsionit, të parashikuara në Kodin tonë Penal, bëhen në frymën e neneve të akteve ndërkombëtare dhe konkretisht të Konventës “Mbi Korrupsionin” (shih vendimin nr.xxx, dt. 03.04.201x të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës).

Në disa raste të vihet re që gjykatat nuk kanë një kuptim të drejtë të elementëve të figurës së veprave penale në fushën e korrupsionit. Raste të tilla krijojnë lëkundje të besimit të publikut dhe në mënyrë të veçantë të ekspertëve të ligjit përsa i takon parimit të paanshmërisë së trupit gjykues.

**Shembull ilustrues 1** - Në çështjen penale të gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. Regjistri nr.xxx, dt. regjistrimi 01.0x.201x, prokurori ngre akuzën për një aferë midis punonjësve doganierë dhe subjektit të një shoqërie tregtare në fushën e hidrokarbureve. Gjykata çmon se, për të qenë para provueshmërisë së akuzës së parashikuar nga neni 244 e 25 i Kodit Penal, duhet të provohet detyrimisht dhënia e përfitimeve të paligjshme të çdo lloji. Në çështjen në fjalë, u vërejt se interpretimi që gjykata i bën nenit 244 të Kodit Penal nuk ishte i plotë dhe i harmonizuar, pasi kjo dispozitë nuk kërkon detyrimisht dhënien e përfitimeve të paligjshme, por nga ana objektive mund të realizohet edhe nëpërmjet premtimit ose propozimit, drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përfitimit të parregullt.

Gjithashtu janë vërejtur edhe vendime gjyqësore, në të cilat, mënyra se si bëhet analiza nëse ka ose jo vepër penale nuk i përgjigjet plotësisht elementeve të figurës së veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar.


Praktika gjyqësore evidenton shpesh nevojën për qartësim të legjislacionit penal përsa u takon elementeve të veprës penale.

**Shembull ilustrues 2** - Referuar një vendimi të Gjykatës së Krimeve të Rënda, vlerësojmë se vlen të diskutohet më gjerë nevoja për saktësimin ose qartësimin e subjekteve të posaçëm të parashikuar në nenin 319/ç të Kodit të Procedurës Penale që sanksionon korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Konkretisht, kush do të konsiderohet funksionar i organeve të drejtësisë? Sa më e qartë të jetë dispozita, aq më shumë kufizohen mundësitë për zbatimin jo të njëtrajtshëm të saj në praktikë. Në këtë vendim gjyqësor, kur analizon subjektin e posaçëm të figurës së kësaj vepre penale,

Gjykata e Krimeve të Rënda evidenton se është e papërcaktuar qartë se çfarë do të kuptojmë me “funksionarë të drejtësisë” dhe këtu në vlerësimin e gjykatës mund të përfshihen sekretarët gjyqësorë, sekretaria e prokurorëve, kancelarët. Në këtë vendim, gjykata vlerëson se i pandehuri me profesion “avokat” do të konsiderohet funksionar i organeve të drejtësisë në bazë të nenit 319/ç të Kodit Penal. Megjithatë, nga interpretimi sistematik dhe harmonik i kuadrit tonë ligjor të brendshëm, KShH vëren se termi “funksion” së pari i referohet funksionarëve dhe zyrtarëve të lartë dhe së dyti, shtrihet në sektorin publik. Sipas ligjit organik për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë (nr. 9109, dt. 17.07.2013), rezulton se avokatia është profesion i lirë, i pavarur, i vetë rregulluar dhe i vetëdrejtuar.

## 7.9 Qëndrimi i gjykatës për kualifikimin ligjor të veprës penale dhe politikën penale


Nga studimi i vendimeve është vënë re se funksionarët apo zyrtarë të lartë publikë, ose funksionarë të sistemit të drejtësisë, edhe në ato raste të pakta kur deklarohen fajtor marrin dënime minimale për të cilat urdhërohet nga gjykata pezullimi i ekzekutimit të tyre. Politika penale ndaj funksionarëve të lartë që akuzohen për veprat penale të korrupsionit paraqitet e ndryshme në vendime të gjykatave të ndryshme. Si më poshtë evidentohet se në sa raste të pandehurit janë konsideruar fajtor dhe sa të pafajshëm sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin.



**Paraqitja grafike Nr.10 – Politika penale ndaj të pandehurve për veprat penale të korrupsionit**



Në paraqitjen grafike të radhës pasqyrohen të dhënat për ndëshkueshmërinë e veprave penale të korrupsionit në sektorin publik, duke marrë si referencë dispozitat e Kodit Penal që janë objekt i këtij studimi:



*Paraqitja grafike Nr.11 – Politika penale sipas dispozitave të Kodit Penal*

**a) Dënimet kryesore**

Të dhënat e analizuara evidentojnë se, për veprat penale të korrupsionit në sektorin publik, janë aplikuar këto dënime kryesore:

- Dënimi me burg është aplikuar ndaj 26 të pandehurve;
- Dënimi me gjobë dhe burg është aplikuar ndaj 3 të pandehurve.

Me ndryshimet që Kodi Penal pësoi nëpërmjet miratimit të ligjit Nr.144, dt. 02.05.2013, dy saktësime u bënë në këtë drejtim:

**Së pari**, neni 34, paragrafi 5 u ndryshua me këtë përmbajtje: “Për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ose, në mungesë të tyre, dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë”.

**Së dyti**, në të gjitha ato dispozita të pjesës së posaçme të Kodit Penal u shfuqizuan pjesët që parashikojnë edhe dënimin me gjobë si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim (duke përfshirë këtu veprat penale që janë objekt i këtij studimi).

Ajo që evidentoher nga studimi i vendimeve është se në asnjë rast nuk është aplikuar maksimumi i dënimit, dhe në të shumtën e tyre është dhënë dënim minimal. Nga 25 të pandehur të dënuar me burgim, vlen



të theksohet se 22 prej tyre kanë përfituar nga ulja e 1/3 së dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar. Si rrjedhojë, në disa raste vihet re se dënimi përfundimtar është nën kufijtë e minimumit të dënimit të parashikuar nga vepra penale.

Prirja e Gjykatave të Apelit është të mos e ndryshojë vendimin e dhënë nga Gjykatat e Shkallës së Parë. Edhe në ato pak raste kur ndryshohet ky vendim, dënimi i dhënë ulet akoma më shumë, në mënyrë të veçantë për subjektet e posaçme të veprës penale që mbajnë funksione të larta apo të rëndësishme publike (gjyqtarë).

#### b) *Dënimet alternative dhe dënimet plotësuese*

Për 13 të pandehur, gjykatat kanë dhënë dënimin alternativ të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i Ekzekutimit të Dënimit me Burgim dhe vënia në provë”, përkatësisht për 5 të pandehur të dënuar për nenin 244 të Kodit Penal, 7 të dënuar për nenin 259 dhe një të dënuar për nenin 319/ç të këtij Kodi. Në 6 raste, Gjykata, paralelisht me dhënien e dënimit alternativ, ka aplikuar edhe nenin 60, që parashikon detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, përkatësisht sipas pikave 1 ose 9 të këtij neni ose të dyja bashkërisht, të cilat parashikojnë “Detyrimin e ushtrimit të një veprimtarie profesionale ose marrjen e një arsimi apo formimi profesional” dhe “Mos shoqërimin me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorë të veprës penale”. Kryesisht dënimet alternative aplikohen në ato raste kur ka kërkesë nga prokuroria dhe ka gjithashtu gjykim të shkurtuar.

Në 4 raste gjykata ka dhënë paralelisht me dënimin alternativ, edhe dënim plotësues. Të pandehurit ndaj të cilëve janë dhënë këto dënime plotësuese janë dënuar për nenin 259, përkatësisht 3 të pandehur dhe nenin 319/ç, një i pandehur. Këto dënime konsistojnë në “Ndalimin e të drejtës për të ushtruar funksione publike”, parashikuar nga neni 30, pika 1 e Kodit Penal dhe “Heqja e të drejtës për të ushtruar funksione publike”, sipas afateve dhe llojit të veprës penale për të cilën është dënuar i pandehuri.

#### c) *Analiza e kritereve për llojin dhe masën e dënimit*

Në llojin dhe masën e dënimit për veprat penale në fushën e korrupsionit, gjykata merr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë e të pandehurit, shkallën e fajit, pranimin e akuzës dhe të fajësisë nga i pandehuri, kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, rrethanat lehtësuese të parashikuar nga nenin 48/ç i Kodit Penal, gjendjen ekonomike dhe familjare, mënyrën e jetesës dhe të nevojave, moshën, pasojën dhe dëmin e ardhur si rezultat i përfitimit në mënyrë të kundra

ligjshme, si dhe kryerjen e veprës me dashje. Në disa vendime gjyqësore, vërehet se elementët që kanë lidhje me gjendjen ekonomike dhe familjare nuk analizohen në vendim dhe nuk referohen provat të cilat provojnë ekzistencën e tyre.

Në shumicën e vendimeve nuk merret parasysh dhe as nuk argumentohet si element në caktimin e masës së dënimit, pasoja dhe dëmi i ardhur apo vlera e shpërblimit ose përfitimi që ka marrë i pandehuri, kryesisht si rezultat i korrupsionit pasiv. Në disa vendime vërehen vlera relativisht të vogla përfitimi. Ajo që evidentohet në vendime të ndryshme është se nuk ka proporcionalitet midis masës së dënimit dhe vlerës së mitës që është marrë/dhënë nga i pandehuri. Madje në disa raste, persona që janë dënuar për korrupsion pasiv për shuma relativisht të ulëta në të holla dënohen njësoj si persona që korruptohen në vlera të konsiderueshme.

Raste të veçuara evidentojnë interpretime atipike të gjykatës në caktimin e dënimit, të cilat nuk arsyetohen në vendim se mbi ç'prova mbështeten. Kështu, Gjykata e Krimeve të Rënda (vendimi nr. xxx, datë 18.xx.201x), deklaroi fajtor një gjyqtar për korrupsion pasiv. Në arsyetimin e dënimit gjykata vlerëson se "ndryshe nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, i pandehuri rezulton të jetë një person me personalitet të mirë dhe të vlerësuar shoqëror në komunitetin ku jeton, i vlerësuar edhe publikisht. Vlen të përmendet në këtë raport, se kur analizon shkallën e rrezikshmërisë së autorëve të veprës penale "Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", gjykata vlerëson se rrezikshmëria e të pandehurve çmohet se është jo e vogël.

Shembujt pozitivë të një analize të plotë në vendimet e studiuara, sa i takon caktimit të llojit dhe të masës së dënimit janë të paktë. Raste të veçuara evidentojnë se gjykata, në caktimin e masës së dënimit synon që i pandehuri ose e pandehura të marrë një dënim që t'i vlejë për rehabilitimin, edukimin ose ri integrimin. Në këto raste gjykata ndjek linjën e një politike penale bashkëkohore dhe jo të ashpër. Në raste të veçanta, gjykata merr në konsideratë në individualizimin e dënimit, faktin se vepra penale e korrupsionit është problematike jo vetëm për efekte të së drejtës por edhe për ndërtimin e shtetit ligjor.

Në vendimet e studiuara ka rezultuar se kryesisht Gjykata ka tendencën të japë të njëjtën masë dënimi të kërkuar nga prokuroria dhe kjo vërehet më së shumti në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për çështjet e tjera, gjykata e lehtëson pozitën e të pandehurit/ve duke ulur masën e dënimit me burgim, ose duke aplikuar një nga alternativat e dënimit me burgim ose duke mos aplikuar dënimet plotësuese të kërkuara nga prokuroria si p.sh. heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike.

Për caktimin e dënimeve alternative, gjykata argumenton të njëjtat shkaqe si për caktimin e dënimit me burg, duke mos analizuar kushtet dhe rrethanat që diktojnë Specifikisht aplikimin e këtyre dënimeve. Edhe për zbatimin e dënimeve plotësuese jo gjithmonë analizohen në vendimet gjyqësore shkaqet ose rrethanat që çmohen të rëndësishme nga gjykata.

Si konkluzion të përgjithshëm, mund të themi se praktika e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në gjykimin e atyre veprave penale në fushën e korrupsionit që ka në kompetencë lëndore, është më e unifikuar sa i takon ndëshkueshmërisë, caktimit të dënimeve duke përfshirë këtu edhe ato plotësuese, si dhe analizës më të plotë që reflektohet në këto vendime. Bazuar edhe në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, te vendimet e studiuara rezultojnë të dënuar funksionarë të lartë të qeverisjes vendore, gjyqtarë dhe avokatë.

## 8. Rekomandime

- i. Për të mundësuar kryerjen e studimeve dhe raporteve analitike më të plota, profesionale dhe gjithëpërfshirëse, thelbësore dhe e detyrueshme është që organet publike të respektojnë të drejtën e informimit të parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës dhe ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda afateve ligjore të përcaktuara, në funksion të garantimit të transparencës dhe parimit të mirëqeverisjes. Referuar gjetjeve të këtij studimi, ky rekomandim i drejtohet veçanërisht organit të prokurorisë, përkatësisht të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- ii. KShH inkurajon Prokurorinë e Përgjithshme dhe KLSH të kryejnë studime më të fokusuara dhe tekniko-profesionale, si edhe një analizë më të thellë dhe krahasuese të veprimtarisë së tyre, përsa i takon fenomenit të pandëshkueshmërisë, të lidhur me rastet e denoncuar nga KLSH, të hetuara nga Prokuroria dhe të gjykuara nga Gjykatat. Gjithashtu vlerësojmë se, kjo analizë duhet të shtrihet edhe mbi ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e denoncimeve e të vendimeve të marra nga Prokuroria.
- iii. Rekomandojmë që hetimet ndaj kallëzimeve që lidhen me korrupsionin apo vepra të tjera të ngjashme të jenë të plota, efektive, objektive dhe të gjithanshme, në mënyrë të veçantë mbi kallëzimet për veprat penale në fushën e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës dhe vepra penale të ngjashme me to.
- iv. Organet publike apo institucionet e kontrollit dhe auditimit nuk duhet të ngurojnë kur është rasti të denoncojnë edhe zyrtarë të nivelit të lartë. I njëjti qëndrim duhet mbajtur edhe në hetimet dhe gjykimin e këtyre zyrtarëve nga organet e procedimit penal, në respektim të plotë të parimit kushtetues: përpara ligjit të gjithë janë të barabartë.
- v. I rekomandohet organit të Prokurorisë që vendimet për mos fillimin e procedimit penal dhe pushimit të çështjes penale të jenë të argumentuara dhe, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, t’u njoftohet menjëherë organeve publike apo institucioneve të kontrollit dhe auditimit, ose personave të tjerë denoncues, si dhe të evidentohet e drejta e tyre për t’u ankuar në gjykatë.

- vi. U rekomandohet organeve publike, veçanërisht institucioneve të kontrollit dhe auditimit që bëjnë denoncime se, kur binden që mos fillimi apo pushimi i çështjes penale nga organet e Prokurorisë nuk është i bazuar, të ushtrojnë brenda afatit ligjor të drejtën e ankimit në gjykatë, duke pasur në konsideratë që, në kuadër të reformës në drejtësi, këto vendime kundërshtohen vetëm në rrugë gjyqësore.
- vii. u sugjerojmë institucioneve që kanë të drejtën e nismës ligjore të propozojnë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, me qëllim që në dispozitat e këtij Kodi të bëhet e qartë e drejta e çdo organi publik denoncues për të kundërshtuar në gjykatë vendimet e mos fillimit apo pushimit të çështjes penale.
- viii. Gjatë raportimeve në Komisionet Parlamentare, ne sugjerojmë që institucionet kushtetuese, ato të pavarura, ose të krijuara me ligj të informojnë edhe mbi të dhënat e ecures së hetimit të denoncimeve të bëra në Prokurori, si dhe arsyet për mos ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të mundshme të mos fillimit apo pushimit të procedimit penal të Prokurorisë.
- ix. I rekomandohet ligjvënësit të marrë në shqyrtim propozimin e KLSH-së për hartimin dhe miratimin e ligjit “Për përgjegjësinë materiale”, mbi trajtimin e përgjegjësisë financiare të zyrtarëve të lartë dhe punonjësve të të gjitha niveleve, për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me ushtrimin e detyrave dhe funksioneve publike.
- x. Për shkak të vonesave të vazhdueshme të konstatuara në çeljen e seancave gjyqësore të cilat përbejnë shkelje disiplinore të gjyqtarëve, nevojitet një organizim i brendshëm më i mirë i punës nga vetë gjyqtarët. Në përputhje me ligjin e ri Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” u rekomandohet kryetarëve të gjykatave të mbikëqyrin disiplinën në punë të gjyqtarëve në këtë drejtim, duke kërkuar nëse është rasti, fillimin e hetimit, kur dyshohen shkelje disiplinore të gjyqtarëve në gjykatat përkatëse.
- xi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka një numër të vogël sallash gjykimi, në krahasim me numrin relativisht të madh të gjyqtarëve dhe të çështjeve të gjykuara prej tyre, me qëllim që të mos cënohet publiciteti i seancave gjyqësore, i sanksionuar në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Rekomandohet shfrytëzimi me efikasitet maksimal të të gjitha sallave të gjykimit

në këtë gjykatë. Gjithashtu sugjerohet rritja e buxhetit gjyqësor që do të mundësonte shtimin e ambienteve të dedikuara për salla gjykimi pranë kësaj gjykate. U rekomandohet punonjësve të sigurisë në gjykata që të garantojnë sigurinë e zhvillimit të gjyqimit pa cënuar pjesëmarrjen e publikut në këto seanca.

- xii. U rekomandohet organeve ekzistuese dhe organeve të reja të sistemit të drejtësisë, që do të krijohen me ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që të kryejnë inspektime të vazhdueshme institucionale dhe tematike mbi çdo aspekt të mbarëvajtjes së punës në gjykata, duke i kushtuar gjithashtu rëndësi respektimit të parimit të solemnitetit për mbajtjen e veshjes së posaçme së gjyqtarëve.
- xiii. Sugjerohet përmirësimi dhe unifikimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve, i cili do mundësojë aksesin on-line nëpërmjet faqeve të këtyre gjykatave lidhur me objektin e çështjeve, ecurinë, kohëzgjatjen, kalendarin e çështjeve, etj. Përveç publikut, kjo do t’u vinte në ndihmë studiuesve dhe organizatave *think tank* që kryejnë studime për veprimtarinë e gjykatave. Sipas ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, kompetencën mbi përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve e ka Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili do të përcaktojë gjithashtu rregulla për funksionimin dhe sigurinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, si edhe për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi.
- xiv. Rekomandojmë që niveli i mbrojtjes, në mënyrë të veçantë ai i ofruar nga avokatët e caktuar kryesisht të jetë më cilësor, ndërkohë që gjykatave u rekomandojmë zbatimin rigoroz të parimit të barazisë së armëve juridike.
- xv. Rekomandojmë të merren masa organizative dhe administrative që të respektohet parimi i gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Në mënyrë të veçantë, organit të Prokurorisë i rekomandohet të marrë masa efektive të organizimit të brendshëm, me qëllim që gjykimi të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë dhe seancat të mos shtyhen edhe kur prokurori ka arsye objektive për të mos u paraqitur, siç mund të jetë ngarkesa e punës.
- xvi. U rekomandohet gjithashtu gjykatave që të jenë aktive në disiplinimin e palëve në proces, duke shmangur çdo zvarritje

të qëllimshme të prokurorit, mbrojtësit dhe të të pandehurit. Zvarritjet e pajustificuara duhet të jenë objekt i një analize në radhë të parë nga vetë gjykatat, si dhe nga Prokuroria apo organet vetërregulluese të Avokatisë, nëse shkak është bërë prokurori dhe/ose mbrojtësi i të pandehurit. Organet e qeverisjes së Gjqësorit, Prokurorisë dhe organet vetërregulluese të Avokatisë duhet të kryejnë inspektive/monitorime tematike të vazhdueshme dhe periodike lidhur me këtë problematikë tepër shqetësuese që cënon procesin e rregullt. Përgjegjësit e zvarritjeve të seancave apo shtyrjeve të pajustificuara duhet të përgjigjen disiplinarisht.

- xvii. Rekomandojmë që afatet ligjore të shqyrtimit të çështjeve të jenë objekt diskutimi gjatë hartimit të ndryshimeve që do t'i bëhen Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, propozojmë parashikimin e afateve të gjykimit sa më të qarta në Kod, të cilat mundësojnë zhvillimin e procesit brenda një kohe të arsyeshme, duke parashikuar përjashtimisht zgjatjen e këtyre afateve në rrethana të caktuara ose komplekse që e bëjnë objektivisht të pamundur përfundimin e gjykimit brenda tyre.
- xviii. KShH rekomandon se gjykata duhet t'i përmbahet kërkesës së ligjit procedural penal lidhur me përmbajtjen e vendimit, përkatësisht me elementët përbërëse të tij. Vendimet gjyqësore duhet të shpallen të arsyetuara. Në këtë drejtim u rekomandojmë institucioneve që kanë të drejtën e nismës ligjore të propozojnë shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, për të saktësuar më mirë këtë detyrim të gjykatës në nenin 384 të këtij Kodi, me përjashtim të vendimeve për çështje veçanërisht komplekse që kërkojnë kohë për arsyetim, duke vendosur në çdo rast afate arsyetimi që nuk çenojnë të drejtën e subjekteve të procedimit penal për ankim efektiv ndaj vendimit gjyqësor.
- xix. Rekomandohet që të evidentohet në vendimet gjyqësore gjendja gjyqësore e të pandehurit, duke specifikuar gjithashtu rastet kur i pandehuri ka qenë i dënuar më parë për vepra penale në fushën e korrupsionit.
- xx. Rekomandojmë, ndërkohë, që të bëhen ndryshime në legjislacionin tonë procedural penal, përkatësisht në nenet 403 – 405 të K.Pr.P, me qëllim që të përjashtohen nga gjykimi i shkurtuar disa vepra penale dhe persona me rrezikshmëri të lartë, duke mos i lënë diskrecion të gjerë gjykatës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (organ i ri i parashikuar në ligjin Nr. 115/2016), ose deri në krijimin e tij - Kryeinspektori i KLD-së, rekomandon të zhvillohen inspektive



tematike lidhur me pranimin e kërkesave për gjykim të shkurtuar në proceset penale.

- xxi.** Disponimet e gjykatës në vendimet e studiuara, për paligjshmëri të marrjes së provave gjatë fazës së hetimit apo edhe mospërdorimit të rezultateve të provave të marra nëpërmjet përgjimit, kur ky është kryer në përputhje me procedurën penale, evidentojnë nevojën për kryerjen e hetimeve të plota, cilësore dhe të gjithanshme nga Prokuroria, si dhe për përmirësimin e mekanizmave dhe teknikave të veçanta rreth kërimit të provave në çështjet penale të korrupsionit nga ky organ.
- xxii.** Të shikohet mundësia e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale lidhur me zgjerimin e mjeteve dhe teknikave të veçanta për gjetjen dhe marrjen e provave, veçanërisht për çështje komplekse dhe për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore (krimi i organizuar, korrupsioni, krimet kundër jetës, etj.).
- xxiii.** Rekomandojmë që Shkolla e Magjistraturës duhet të vazhdojë trajnimet në programin e formimit vazhdues, në bashkëpunim me organizmat dhe ekspertët ndërkombëtarë apo vendas, për rritjen e kapaciteteve të magjistratëve në Prokurorinë dhe Gjykatën e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- xxiv.** Rekomandohet të diskutohet më gjerë nevoja për saktësimin, ose qartësimin e subjekteve të posaçme, të parashikuar në nenin 319/ç të Kodit të Procedurës Penale që sanksionon korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Konkretisht, kush do të konsiderohet funksionar i organeve të drejtësisë?

